



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 15.04.2019, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i draftkalendarit të punës së Komisionit të Ligjeve për periudhën 15 prill - 10 maj 2019
2. Shqyrtimi i projektligjit "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Kosovës, për ngritjen e pikave të përbashkëta të kalimit kufitar ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës dhe kryerjen e veprimtarive të përbashkëta të kontrollit kufitar"
3. Shqyrtimi i projektvendimit "Për vlerësimin e kriterëve ligjore të kandidatëve për anëtar të Autoritetit për Informim mbi Dokumentet e ish- Sigurimit të Shtetit, për një vend vakant"
4. Shqyrtimi në parim i projektligjit "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10031, datë 11.12.2008, "Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat", të ndryshuar

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Klotilda Bushka, Fatmir Xhafaj, Vasilika Hysi, Adnor Shameti, Bashkim Fino, Edmond Leka, Alket Hyseni, Spartak Braho, Alban Zeneli, Korab Lita, Aurora Mara, Elena Xhina dhe Adriatik Alimadhi

Mungojnë:

Damian Gjikhuri, Jurgis Çyrbja, Elda Hoti dhe Tom Doshi

Të ftuar:

Rovena Voda – Zëvendësministre e Brendshme

Emirjola Yzeiraj - Shefe e sektorit të Marrëveshjeve në Ministrinë e Brendshme

Xhevair Karaj – Përfaqësues nga drejtoria e Kufirit dhe Migracionit në Ministrinë e Brendshme

Migena Baholli - Specialiste në Drejtorinë e së Drejtës Ndërkombëtare dhe Europiane në Ministrinë për Europën dhe Punët e Jashtme

HAPET MBLEDHJA

Ulsi Manja – Le të hyjnë mediat!

Mirëmëngjesi të gjithëve!

Duke ju uruar një ditë të mbarë dhe një javë të mbarë, fillojmë mbledhjen e Komisionit të Ligjeve.

Kuorumi është i pranishëm për të vazhduar me çështjet që kemi në rendin e ditës.

Përpara se të vazhdojmë me pikat e rendit të ditës, më lejoni që në emrin tim dhe të kolegëve të mi të komisionit t'u uroj mirëseardhjen në Komisionin e Ligjeve deputetëve të rinj të opozitës, zotërinjve Alban Zeneli dhe Korab Lika nga PD-ja, zonjës Aurora Mara nga LSI-ja dhe zotit Adriatik Alimadhi nga Partia e Ballit Kombëtar.

Mirë se erdhët dhe punë të mbarë në Komisionin e Ligjeve!

Shpresoj të kemi një bashkëpunim konstruktiv në funksion të procesit të ligjbërjes, por edhe të kontrollit parlamentar.

Komisioni ynë është komision i përhershëm i Kuvendit, një nga komisionet më të rëndësishëm, që mbulon çështjet ligjore, administratën publike, por edhe pushtetin vendor.

Sot kemi tri çështje në rendin e ditës.

Është miratimi i draftkalendarit të punës së Komisionit të Ligjeve për periudhën 15 prill – 10 maj 2019.

A ka sugjerime nga kolegët e komisionit për kalendarin? Nuk ka.

Miratohet kalendari i punimeve të Komisionit të Ligjeve për periudhën 15 prill – 10 maj 2019.

Vazhdojmë me çështjen e dytë të rendit të ditës, shqyrtimi i projektligjit "Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Kosovës, për ngritjen e pikave të përbashkëta të kalimit kufitar, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës dhe kryerjen e veprimtarive të përbashkëta të kontrollit kufitar".

Në shqyrtimin e këtij projektligji komisioni ynë është komision për dhënie mendimi.

Relator do të jetë kolegu Edmond Leka.

Kanë konfirmuar pjesëmarrjen, nga Ministria e Brendshme, zonja Rovenë Voda, zëvendësministre, zonja Emirjola Yzeiraj, shefja e sektorit të marrëveshjes dhe zoti Xhevair Karaj, nga drejtoria e Kufirit dhe Migracionit.

Mirë se erdhët!

Nga Ministria e Europës dhe Punët me Jashtë kemi zonjën Migena Baholli, specialiste ne Drejtorinë e së Drejtës Ndërkombëtare dhe Europiane.

Mirë se erdhët!

Fillojmë pa humbur kohë.

Zonja Voda, do t'ju lutesha të bënit një prezantim të shkurtër të kësaj marrëveshjeje.

Rovena Voda - Faleminderit!

Projektakti që po diskutohet është një projektakt iniciuar në kuadër të angazhimit të të dyja qeverive, të Republikës së Shqipërisë dhe asaj të Kosovës, me qëllim thjeshtëzimin dhe lehtësimin e procedurave dhe masave lidhur me kontrollet kufitare të menaxhimit të qarkullimit ndërkufitar ndërmjet dy vendeve.

Kjo marrëveshje për pikat e përbashkëta të kalimit kufitar, vjen pas një eksperience të tillë me hapjen e pikës së parë të përbashkët të kalimit kufitar në vitin 2008, pra pikës së Muriqanit, gjë e cila ka treguar se çon në një lehtësim të jashtëzakonshëm të përpunimit të mallrave, por edhe lehtësimin e kalimit në pikat e kalimit kufitar, kryesisht duke pasur parasysh dyndjen e madhe të qytetarëve në periudhën e sezonit turistik. Mjafton që unë të jap disa statistika.

Gjatë viteve të fundit stacioni i policisë kufitare Morinë ka pasur një fluks hyrje-daljes të lartë, sidomos gjatë sezonit veror dhe vetëm gjatë periudhës 9-mujore të vitit të shkuar, janar – shtator 2018, në pikën e kalimit kufitar Morinë janë përpunuar gjithsej 4794138 shtetas me 1470524 mjete.

Gjithashtu, vlen për t'u theksuar se në stacionin e policisë kufitare Morinë është përmirësuar ndjeshëm edhe infrastruktura, pas financimit nga delegacioni i BE-së, i cili ka konsistuar në shtimin e numrit të korsive. Janë gjithsej 12 korsi. Tashmë kabinat ku bëhet kontrolli janë të ndara.

Kjo marrëveshje ka qëllimin e saj që të bëhet “një ndalesë - një kontroll”, pra kemi vetëm hyrje-hyrje. Jo më pak se para një jave unë isha në një vizitë në pikën e kalimit kufitar Morinë dhe gjithçka funksiononte dhe realisht ndihej lehtësimi i lëvizjes së qytetarëve dhe mjeteve me aplikimin e kësaj marrëveshjeje.

Unë do të thosha se kjo marrëveshje lehtëson jo vetëm fluksin e lëvizjes së qytetarëve dhe mjeteve, por nxit edhe bashkëpunimin policor të të dyja vendeve.

Mos të harrojmë se pas investimit të BE-së të kryer në këtë pikë kufitare, kemi tashmë një godinë të përbashkët të autoriteteve policore të Kosovës dhe të Shqipërisë, po ashtu edhe të autoriteteve doganore, gjë e cila lehtësohet edhe me aplikimin e kësaj marrëveshjeje,

shkëmbimin e informacionit, i cili është shumë i rëndësishëm në luftën kundër krimit ndërkufitar, trafikeve të paligjshme, por edhe terrorizmit.

Kjo marrëveshje bazohet në ligjin për marrëveshjet ndërkombëtare nr.43 të vitit 2016, bazuar në nenet 10 dhe 17.

Sigurisht kjo marrëveshje është gjëja e duhur në kuadër të bashkëpunimit ndërkufitar mes dy vendeve.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Voda!

Urdhëroni, zoti Leka!

Edmond Leka - Faleminderit!

Qëllimi i këtij projektligji është thjeshtëzimi dhe lehtësimi i procedurave dhe masave lidhur me kontrollet kufitare të menaxhimit të qarkullimit ndërkufitar ndërmjet dy vendeve.

Marrëveshja parashikon që pikat aktuale jo të përbashkëta të kalimit kufitar të ndryshojnë sipas statusit në pika të përbashkëta të kalimit kufitar, ndërsa pikat e kalimit kufitar që do të krijohen në të ardhmen do të rregullohen sipas parashikimeve të kësaj marrëveshjeje.

Marrëveshja minimizon kohën e përpunimit të të dhënave të shtetasve dhe mjeteve, sepse kontrolli dhe verifikimi kufitar gjatë kalimit do të kryhet nga një pikë e përbashkët.

Si relator e vlerësoj rëndësinë e miratimit të këtij projektligji, i cili është në përputhje me Kushtetutën dhe Rregulloren e Kuvendit.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Leka!

A ka pyetje nga kolegët?

Urdhëroni, zoti Xhafaj!

Fatmir Xhafaj – Kam katër pyetje që duan përgjigje të shkurtra.

1. Sa ka zgjatur në kohë kjo procedurë, nga momenti i vënies në lëvizje deri ditën e nënshkrimit?

2. A ka ndryshim mënyra se si administrohet sipas kësaj marrëveshjeje kjo pikë me atë të Muriqanit apo janë identike nga pika e pikëpamje?

3. Me sa kuptoj, marrëveshja nuk e zgjidh përputhshmërinë e sistemeve për shkëmbimin e të dhënave. Kosova ka sistem tjetër të administrimit të të dhënave. Si do të zgjidhet kjo gjë në këto rrethana?

4. Çfarë po ndodh me projektet e ngjashme të iniciuara me Maqedoninë dhe Greqinë?

Jo rastësisht bëra pyetjen e parë se në të njëjtën kohë ka filluar projekte të tilla të ngjashme, jo vetëm me Kosovën, por edhe me Maqedoninë dhe Greqinë.

Në ç'fazë janë këto projekte?

Ulsi Manja - Faleminderit, zoti Xhafaj!

Urdhëroni, zonja Voda!

Rovena Voda - Faleminderit!

Në fakt, kjo nuk është një punë që sapo u nis. Kam kënaqësinë të them se zoti Xhafaj ka qenë edhe ministri im dhe është bërë një punë shumë e mirë me të gjitha vendet e rajonit dhe këto janë marrëveshje që në fakt kanë nisur që në janar të vitit 2018. Këto janë marrëveshje për të cilat janë këmbyer mendime, drafte me të gjitha palët, kështu që sigurisht që ka qenë një punë e madhe përgatitore për të arritur më pas deri në fund me nënshkrimin e saj, në dhjetor në vitit 2018.

Për sa i përket pyetjes së dytë, me sa jam e informuar, nuk ka ndryshim, është e njëjta mënyrë funksionimi si ajo e pikës së përbashkët të kalimit kufitar në Muriqan.

Për pyetjen e tretë dëshiroj t'ju sqaroj se është e vërtetë që kemi dy sisteme të ndryshme të administrimit të informacionit, ne kemi TIMS-in dhe ata kanë një sistem tjetër, por besoj se në bazë të një marrëveshjeje dhe të protokolleve të përbashkëta apo procedurave standarde që kanë të dyja policitë kufitare është gjetur një mënyrë për të shkëmbyer këto të dhëna.

Për pyetjen e katërt dëshiroj të them se është e drejtë, në fakt, që janë marrëveshje të nisura në të njëjtën kohë, ashtu si me Morinën. Ka pasur goxha vonesë nga të dy vendet fqinje, edhe nga pala greke, edhe nga pala maqedonase për të na kthyer mendimet dhe sugjerimet e tyre për këto marrëveshje.

Në lidhje me pikën e përbashkët të kalimit kufitar me Greqinë ne jemi informuar që nuk do të mund të realizohet. Do të mbetet për t'u realizuar vetëm qendra e përbashkët e bashkëpunimit policor dhe doganor, për shkak se ata janë një vend i BE-së; kanë një sistem të zonës Shengen, që është sistemi SIS, në të cilin ne nuk mund të kemi akses. Kjo është arsyeja.

Për sa i përket marrëveshjes me Maqedoninë e Veriut duke patur parasysh që kishte vonesa dhe goxha komente edhe nga pala maqedonase u kemi propozuar tashmë draftin që sapo është miratuar me Kosovën. Mendojmë se është një draft më i mirë. Presim komentet e tyre të fundit. Shpresoj shumë shpejt që brenda një muaji ta mbyllim, të paktën me Maqedoninë e Veriut pjesën e miratimit të marrëveshjeve për pikat e përbashkëta të kalimit kufitar.

Ulsi Manja- Faleminderit, zonja Voda!

Ka pyetje nga kolegë të tjerë? Nuk ka. Ka diskutime? Nuk ka.

Kalojmë në votimin në parim. Kush është dakord me këtë projektligj? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet në parim projektligji "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Kosovës për ngritjen e pikave të përbashkëta të kalimit kufitar, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Kosovës dhe kryerjen e veprimtarive të përbashkëta të kontrollit kufitar".

Kalojmë në shqyrtimin dhe miratimin nen për nen.

Neni 1. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Neni 2. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Kalojmë në votimin në tërësi. Kush është dakord? Kundër? Nuk ka. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet në tërësi projektligji.

Projektligji së bashku me raportin përkatës të komisionit tonë t'i drejtohet komisionit përgjegjës dhe më pas seancës plenare për votim.

Shumë faleminderit, zonja Voda, zoti Karaj, zonja Yzeiraj dhe zonja Baholli për prezencën tuaj në komision!

Ditë të mbarë!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 15.04.2019, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja - kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi i projektvendimit “Për vlerësimin e kritereve ligjore të kandidatëve për anëtar të Autoritetit për Informim mbi Dokumentet e ish- Sigurimit të Shtetit, për një vend vakant”.

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Klotilda Bushka, Fatmir Xhafaj, Vasilika Hysi, Adnor Shameti, Bashkim Fino, Edmond Leka, Alket Hyseni, Spartak Braho, Alban Zeneli, Korab Lita, Aurora Mara, Elena Xhina dhe Adriatik Alimadhi

Mungojnë:

Damian Gjiknuri, Jurgis Çyrbja, Elda Hoti dhe Tom Doshi

Ulsi Manja - Kalojmë në pikën e tretë të rendit të ditës, në shqyrtimin e projektvendimit “Për vlerësimin e kriterëve ligjore të kandidatëve për anëtar të Autoritetit për Informim mbi Dokumentet e ish- Sigurimit të Shtetit për një vend vakant”. Komisioni ynë është komision përgjegjës. Relator është kolegja Bushka. Dua të sjell në vëmendjen tuaj se në komision janë ezauruar seancat dëgjimore me kandidatët për këtë vend vakant. Në zbatim të Rregullores së Kuvendit, neni 111 i saj komisioni ynë do të bëjë një vlerësim të përmbushjes së kriterëve kushtetuese, ligjore dhe meritën e çdo kandidature pas realizimit të seancës dëgjimore. Më pas lista e kandidatëve që do të miratohen në komision do t’u përcillet grupeve parlamentare, të cilët në përputhje me nenin 111, pika 1 të Rregullores së Kuvendit kanë të drejtën të mbështesin me 28 firma kandidaturat për në seancën plenare. Pastaj do të jetë seanca plenare ajo që do të votojë për një nga kandidaturat për të plotësuar vendin vakant tek Autoriteti për Informim mbi Dokumentet e ish- Sigurimit të Shtetit.

Zonja Bushka do të bëjë një prezantim të shkurtër të përmbushjes së kriterëve ligjore dhe meritës së çdo kandidati. Pastaj ne do t’i votojmë një për një në komision.

Klotilda Bushka – Faleminderit, zoti kryetar!

Siç e parashtroi edhe kryetari pas dëgjesave të organizuara me kandidatët që kanë aplikuar për këtë funksion vakant nga Autoriteti për Informim mbi Dokumentet e ish- Sigurimit të Shtetit është bërë dhe verifikimi i kushteve ligjore, të cilat janë parakusht në mënyrë që ky komision të votojë për kandidatët, për të bërë listën përfundimtare. Kjo e fundit më pas u vihet në dispozicion kolegëve deputetë të Kuvendit për të mbështetur me jo më pak se 28 firma atë kandidat që e çmojnë më të përshtatshëm.

Po i marr me radhë të gjithë kandidatët.

Po filloj me zonjën Ermira Shtino, e cila është propozuar nga Qendra Shqiptare për Rehabilitimin e Traumës. Nëse i referohemi ligjit përkatës “Për të drejtën e informimit mbi Dokumentet e ish- Sigurimit të Shtetit”, ata që kanë të drejtën për të bërë propozime janë shoqatat për ish -të përndjekurit politikë dhe rezulton se propozuesi për zonjën Shtino është një qendër, e cila është organizuar në formën ligjore të një fondacioni. Nëse i referohemi ligji, ai e thotë në mënyrë të qartë: “Shoqatat e ish- të përndjekurve”. Nëse i hyjmë legjitimitetit të atyre që propozojnë. Jo më kot në frymën e tij legjislatori ka vendosur shoqatën si një

strukturë me anëtarësi në mënyrë që vullneti i anëtarëve që kanë qenë të prekur nga këto fenomene të së kaluarës të kenë të drejtën të propozojnë një përfaqësues të tyre. Nëse i qëndrojmë strikt ligjit propozimi i ardhur për zonjën Shtino nuk është një propozim që vjen nga një subjekt që legjitimohet, por zonja Shtino i plotëson të gjitha kriteret e tjera për të qenë kandidate për këtë pozicion.

Kjo është një çështje që mund ta diskutojmë sesi do të vendosim, do ta interpretojmë në mënyrë të zgjeruar apo në mënyrë strikte siç parashikon ligji, por logjika dhe fryma e ligjit kanë të bëjë me faktin se janë shoqatat ato të cilat janë me anëtarësi dhe vendosin për propozimet në lidhje me këtë pozicion.

Vazhdojmë me zotin Besim Ndregjoni, i cili është propozuar nga shoqata, që legjitimohen për të bërë propozime. Plotëson të gjitha kushtet ligjore, por për sa i përket kushtit të përvojës prej 10 vjet, pra jo më pak se 10 vjet në profesion, zotit Ndregjoni i mungojnë rreth 5 muaj, ka 9,7 muaj në profesion.

Zoti Gjergj Marku përmbush të gjitha kriteret e përcaktuara në ligjin “Për të drejtën e Informimit mbi Dokumentet e ish- Sigurimit të Shtetit”.

Zoti Pëllumb Gjuta, gjithashtu i përmbush të gjitha kriteret ligjore.

Zonja Nevila Nika ka të njëjtën situatë me zonjën Shtino, propozohen nga një fondacion dhe jo nga një shoqatë me anëtarësi e ish- të përndjekurve politikë.

Zoti Selami Zalli i përmbush të gjitha kriteret ligjore të përcaktuara në ligjin “Për të drejtën e Informimit mbi Dokumentet e ish- Sigurimit të Shtetit”.

Zoti Skënder Vrioni i plotëson kriteret ligjore, por edhe për zotin Vrioni duhet të diskutohet në një interpretim më të zgjeruar të nenit 8 të ligjit “Për të drejtën e informimit mbi Dokumentet e ish- Sigurimit të Shtetit” pasi shoqata propozuese nuk është një shoqatë e cila është tipike për ish - të përndjekurit politikë, por është një shoqatë, e cila ka në objektin e punës së saj rikthimin në kujtesë të fenomeneve negative të kohës së komunizmin dhe ruajtjen e kujtesës historike për këto fenomene.

Zoti Ulusi Bici përmbush të gjitha kriteret ligjore të përcaktuara në nenin 9 të ligjit.

Me pak fjalë këto janë vlerësimet për të mos u zgjatur shumë në kriteret ligjore procedurale, në teknikalitete, përveç 3 kandidatëve që e paraqita se cili është problemi, që ka të bëjë me interpretimin sesi do ta vendosim të gjithë bashkë.

Kandidatët që i kanë të plotësuar të gjitha kriteret janë: Gjergj Marku, Pëllumb Gjuza, Selami Zalli, Skënder Vrioni dhe Ulusi Bici.

Për 3 kandidatët e tjerë le të vendosim së bashku nëse do t'i kalojmë në mënyrë të qartë për sa i përket interpretimit të ligjit. Nëse do të bëjmë një interpretim të zgjeruar apo do të mbetemi te fryma e çështjes së shoqatave me anëtarësi.

Edhe një herë kandidatët që i plotësojnë kushtet pa diskutimet që paraqita më parë janë: Gjergj Marku, Pëllumb Gjuza, Selami Zalli, Skënder Vrioni dhe Ulusi Bici.

Ulsi Manja- Faleminderit, zonja Bushka!

Unë personalisht nuk mendoj se mund t'i japim interpretim të zgjeruar apo të ngushtuar ligjit, por sugjeroj t'u qëndrojmë strikt neneve 8 dhe 9 të ligjit nr.45 të vitit 2015, siç e prezantoi kolegja Bushka. Bëhet fjalë për vendin vakant të krijuar pas dorëheqjes së zotit Gumenji nga Autoriteti për të Drejtën e Informimit mbi Dokumentet e ish- Sigurimit të Shtetit në Republikën e Shqipërisë. Neni 8, germa "c" thotë: "Një përfaqësues i propozuar nga shoqatat e të përndjekurve nga radhët e kandidatëve, të mbështetur nga jo më pak se 28 deputetë". Pra, vetëm kandidatët që kanë një propozim konkret nga shoqatat e ish- të përndjekurve politike mund të jenë pjesë e kësaj gare. Neni 9 i ligjit, ka përcaktuar kushtet për t'u zgjedhur anëtar. Një nga kushtet është: kandidati të ketë jo më pak se 10 vjet përvojë në ushtrimin e profesionit.

Me të drejtë relatorja përfshin në këtë listë të kandidatëve që plotësojnë kriteret siç është zoti Vrioni, sepse zoti Vrioni me sa shikoj është propozim i Shoqatës Shqiptare të Rrëzimit të Simboleve Komuniste, që në objektin e tyre ka pikërisht përkatësinë e të qenit shoqatë e ish- të përndjekurve politike.

Unë jam dakord që lista e kandidatëve që plotësojnë kriteret të jetë kjo që propozon relatorja: zoti Gjergj Marku, zoti Pëllumb Gjuza, zoti Selami Zalli, zoti Skënder Vrioni dhe zoti Ulusi Bici.

Ne thjesht si Komisioni i Ligjeve do të miratojmë listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret ligjore, por më pas në bazë të nenit 111, pika 1, të Rregullores së Kuvendit kjo listë me këto emra do t'u shkojë deputetëve, 140 deputetëve dhe grupeve parlamentare, të cilët me 28 firma mund të mbështesin cilindo nga këta kandidatë që plotësojnë kriteret ligjore.

E thënë më qartë, unë do të hedh në votim listën. Jeni dakord? Po, zoti Lita ka pyetje.

Korab Lita- Në frymën e asaj që tha zoti kryetar, unë mendoj se nga kjo listë duhet të përjashtohen vetëm garuesit që nuk e plotësojnë kushtin e propozimit nga shoqatat e ish- të përndjekurve. Siç shihet edhe nga situata, kjo kandidaturë dhe ky vend është në mënyrë eksplicite vetëm për përfaqësues të këtyre shoqatave. Pra, nuk ka asnjë lloj arsyeje të përfshihen në garë persona të tjerë.

Për sa u përket personave të tjerë të cilët për diçka të vogël, për disa muaj punë, mbeten, nëse ata e kanë propozimin nga shoqatat, le t'ua lëmë këtë ekskulzivitet shoqatave dhe të shkojnë në seancën plenare ose në rrugën tjetër ligjore. Pra, konkretisht jam vetëm kundër propozimeve që nuk kanë ardhur nga shoqatat për ish- të përndjekurit.

Ulsi Manja - Faleminderit, zoti Lita!

Po, zoti Fino.

Bashkim Fino – Kam një pyetje. Besim Ndregjonaj, i plotëson kriteret, vetëm 5 muaj i mungojnë në profesion, por është korrekt në sensin e propozimeve nga shoqatat antikomuniste. Po t'i qëndrojmë strikt ligjit dakord, por ligjet për pesë muaj, thjesht për profesion, ndërkohë që, si ata katër që përmendët ju më lart, edhe ky. Pastaj, është tjetër gjë se cili do t'i marrë njëzet e tetë firmat.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Fino!

E tha edhe relatorja. Lidhur me kandidaturën e zotit Ndregjoni, është ky problem, por nëse ka propozime, dhe kolegët e komisionit e mbështesin që ne ta kalojmë për atje, unë patjetër e hedh në votim.

Pra, bëhet fjalë për një periudhë katërmujore, pesëmujore, me sa parashtrohet relatorja, që vjen si propozim i shoqatës, por ka këtë mungesë kohore.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, jo. janë katër shoqata të përndjekurish.

Po, zonja Bushka.

Klotilda Bushka – Në fakt, zoti Ndregjoni është propozuar nga të gjitha shoqatat e të përndjekurve.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të tjerët e listës janë propozuar nga shoqata të tjera.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nga një shoqatë, ndërsa zoti Ndregjoni është propozuar nga më shumë se një shoqatë.

Ulsi Manja – Atëherë kush është dakord që, sipas propozimeve të kolegëve, zonjës Bushka, zotit Lita dhe zotit Fino, listës së kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret ligjore t'i shtohet edhe emri i Besim Ndregjonit? Dakord?

Pro? Kundër s'ka. Abstenim s'ka.

Atëherë, edhe zoti Ndregjoni bëhet pjesë e listës së kandidatëve që plotësojnë kushtet e kriteret ligjore.

Nëse nuk ka diskutime të tjera, le ta hedhim listën në votim.

Kush është dakord me listën?

Pro? Kundër s'ka. Abstenim s'ka.

Këshilltarët e komisionit le ta bëjnë gati listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret ligjore, dhe t'ua vënë në dispozicion deputetëve dhe grupeve parlamentare, për të vazhduar pastaj me procedurat e tjera që parashikon Rregullorja.

Kandidatët që u votuan dhe që plotësojnë kushtet e kriteret ligjore janë: zoti Gjergj Marku, zoti Pëllumb Gjuta, zoti Selami Zalli, zoti Skënder Vrioni, zoti Ulusi Bici dhe zoti Besim Ndrejoni.

Shumë faleminderit!



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

PROCESVERBAL

Tiranë, më 15.04.2019, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Ulsi Manja – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

Shqyrtimi në parim i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10031, datë 11.12.2008 “Për shërbimin përmbartimor gjyqësor privat”, të ndryshuar

Marrin pjesë:

Ulsi Manja, Klotilda Bushka, Fatmir Xhafaj, Vasilika Hysi, Adnor Shameti, Bashkim Fino, Edmond Leka, Alket Hyseni, Spartak Braho, Alban Zeneli, Korab Lita, Aurora Mara, Elena Xhina dhe Adriatik Alimadhi

Mungojnë:

Damian Gjijnuri, Jurgis Çyrbja, Elda Hoti dhe Tom Doshi

Të ftuar:

Edvin Kukunja - Këshilltar i Ministrit të Drejtësisë

Katrin Treska - Drejtore e Përgjithshme e Drejtorisë së Përgjithshme Rregullatore të Çështjeve të Drejtësisë në Ministrinë e Drejtësisë

Eljona Bylykbashi - Përgjegjëse e Sektorit të Reformave Ligjore dhe përafrimit të legjislacionit në Ministrinë e Drejtësisë

Jos Uitdehaag – Ekspert ndërkombëtar nga EURALIUS

Idlir Peçi – Ekspert ndërkombëtar nga EURALIUS

Tedi Dobi – Ekspert vendas nga EURALIUS

Tedi Malaveci – Kryetar i Dhomës Kombëtare të Përmbaruesve Gjyqësor Privatë

Zef Macaj - Nënkryetar i Dhomës Kombëtare të Përmbaruesve Gjyqësor Privatë

Besmir Kodra - Sekretari i përgjithshëm i Dhomës Kombëtare të Përmbaruesve Gjyqësor Privatë

Alban Ruli - Kryetari i Këshillit të Dhomës Kombëtare të Përmbauesve Gjyqësor Privatë

Ulsi Manja – Kalojmë te pika tjetër e rendit të ditës.

Është shqyrtimi i projektligjit Shqyrtimi në parim i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10031, datë 11.12.2008, “Për shërbimin përmbauesor gjyqësor privat”, të ndryshuar.

Komisioni ynë është komision përgjegjës. Relator do të jetë kolegu Alket Hyseni. Kanë konfirmuar pjesëmarrjen:

Nga Ministria e Drejtësisë: zonja. Katrin Treska, drejtore e Përgjithshme e Drejtorisë së Përgjithshme Rregullatore të Çështjeve të Drejtësisë; z. Edvin Kukunja, këshilltar i ministrit të Drejtësisë; zonja Eljona Bylykbashi, përgjegjëse e Sektorit të Reformave Ligjore dhe Përafrimit të Legjislacionit.

Nga Misioni EURALIUS: zoti Jos Uitdehaag, ekspert ndërkombëtar; zoti Ildir Peçi, ekspert ndërkombëtar; zoti Tedi Dobi, ekspert vendas.

Nga Dhoma Kombëtare e Përmbauesve Gjyqësorë Privatë: zoti Tedi Malaveci, kryetari i Dhomës; zoti Zef Macaj, nënkryetari; zoti Besmir Kodra, Sekretari i Përgjithshëm; zoti Alban Ruli, kryetari i Këshillit.

U uroj mirëseardhjen në komision të gjithë përfaqësuesve të institucioneve, që sapo prezantova: nga Ministria e Drejtësisë, nga misioni EURALIUS, nga Dhoma Kombëtare.

E thashë që në fillim: relator do të jetë kolegu Alket Hyseni. Sot kemi vetëm diskutimin dhe miratimin në parim të projektligjit “Për shërbimin përmbauesor gjyqësor privat”, të ndryshuar. Ky është një nga prej projektligjeve të fundit që kemi në diskutim, nga paketa e dytë prej 27 ligjesh të reformës në drejtësi.

Nuk e di, zoti Hyseni, t’ua japim fjalën ekspertëve, që të bëjnë një prezantim të projektligjit, apo do ta bëni ju prezantimin.

Zoti Hyseni një prezantim të shkurtër, e më pas ekspertët, të cilët do të bëjnë një prezantim në detaje të këtij projektligji.

Fjala është për ju!

Alket Hyseni – Faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar anëtarë të komisionit,

Të nderuar të ftuar,

Po fillojmë në këtë komision shqyrtimin e projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10031, datë 11.12.2008, “Për shërbimin përmbartimor gjyqësor privat”, të ndryshuar.

Ky është projektligji i fundit në shtyllën e profesioneve të lira, në kuadër të paketës prej 27 projektligjesh, në kuadër të reformës në sistemin e drejtësisë.

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut është në cilësinë e komisionit përgjegjës.

Sikurse është në dijeni edhe opinioni publik, që më 16 dhjetor 2016, në Komisionin e Posaçëm Parlamentar për Reformën në Sistemin e Drejtësisë u prezantua një paketë e plotë prej 27 projektligjesh, të hartuara nga ekspertë të nivelit të lartë, së bashku me ekspertë ndërkombëtarë të EURALIUS e OPDAT, të inkuadruar në këtë komision.

Kuvendi i Shqipërisë vendosi mbylljen e veprimtarisë së komisionit, dhe të 27 projektligjet iu kaluan për shqyrtim Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut. Një nga ato projektligje është edhe ky, i cili në fakt është nismë deputetësh, një nismë e kolegëve Edmond Leka dhe Jurgis Çyrbja. Në analizë të nenit 81, pika 2 të Kushtetutës dhe përmbajtjes së tij konkrete, ky projektligj kërkon një shumicë të thjeshtë dhe jo shumicë të cilësuar.

Ju jeni në dijeni të faktit se për sistemin e drejtësisë është bërë një analizë e thelluar, para bërjes së gjithë kësaj pakete, analizë e cila nxori një sërë problematikash lidhur me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore: zgjatje të pajustificuara në ekzekutimin e titujve ekzekutivë, mungesë transparence dhe përkushtimi në ushtrimin e detyrave, vonesa të pafundme në ekzekutim, paqartësi ligjore në shumë raste, kur një përmbartues gjyqësor privat është subjekt i pezullimit të përkohshëm të veprimtarisë, shpesh duke sjellë vështirësi në ushtrimin funksioneve të vetë përmbartuesve privatë, mungesë e trajnimit të vazhdueshëm të përmbartuesit privat, licencimi problematik, le të themi, dhe pa kritere strikte i përmbartuesve privatë, problematika në çështjet e procedimeve disiplinore të organeve, mënyrës së ndërtimit, kompetenca jo të plota apo të mangëta të Dhomës së Përmbartuesve Privatë, si dhe plot probleme të tjera, të cilat janë evidentuar në këtë analizë të sistemit të drejtësisë, por me të cilat është ndeshur edhe vetë opinioni publik, por edhe pas kësaj analize kanë dalë në pah probleme të tjera.

Prandaj, edhe drafti i paraqitur nga kolegët ka synuar pikërisht të orientojë këto problematika, por edhe një pjesë të problematikave të tjera, që në fakt nuk kanë qenë evidentuar në mënyrë të plotë nga analiza e sistemit të drejtësisë.

Unë do të ndalem shkurtimisht në aspekte procedurale të procesit që kemi ndjekur për shqyrtimin e këtij projektligji, për t'i lënë ekspertëve bërjen e një pasqyre më të qartë teknike dhe përmbajtjes konkrete të projektligjit.

Në parim, do të doja t'ju bëja me dije se është një projektligj, i cili si synim bazë ka pasur edhe përafrimin me aktet ndërkombëtare, kryesisht me rekomandimin numër 17 të Këshillit të Europës “Për ekzekutimin përmbarimor”, me udhëzuesin nr. 11 të Komisionit European “Për eficiencën në sistemin e drejtësisë”, si dhe Kodin global të ekzekutimit të detyruar.

Elementët bazë të këtyre rekomandimeve janë: bërja e një kornize të plotë ligjore në këtë fushë; parashikimi o sigurisë ligjore dhe transparenca e procesit; detyrimi i palëve për bashkëpunim, për të bërë një proces jo thjesht mekanik, por harmonik mes palëve; patjetër balancimi i interesave midis kreditorëve dhe debitorëve, duke pasur në themel të tij dispozitat e neneve 6 dhe 8 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut; kriteret e larta profesionale dhe etike të përmbaruesve, dhe plot rekomandime të tjera parimore, të cilat jo se nuk kanë qenë tërësisht në ligjin ekzistues.

Në këtë kuadër, është përgatitur nga ekspertët dhe është prezantuar nga kolegët projektligji-draft, i cili është paraqitur në Kuvend, por sikurse e thashë, pas një analize të mëvonshme më të thelluar është gjykuar se, për shkak të nevojave të harmonizimit të këtij projektligji me gjithë paketën e reformës në drejtësi, për të sanksionuar mundësinë e ofrimit të shërbimit përmbarimor edhe ndërmjet subjekteve tregtare, gjë që ka sjellë interpretime dhe probleme në të kaluarën; për të rregulluar mirë trajnimin fillestar, por patjetër edhe trajnimin e vazhdueshëm të përmbaruesve; për të sanksionuar dispozita më të qarta për papajtueshmërinë me detyra të tjera të përmbaruesve gjyqësorë, të cilat janë funksione të lejueshme; për forcimin me rigorozitet të kushteve për licencimin dhe certifikimin e përmbaruesve gjyqësorë; për modalitete strikte lidhur me llogarinë bankare të përmbaruesit, pra një llogari e re e veçantë, vetëm për qëllime përmbarimore dhe jo për qëllime tregtare; për një kornizë më të plotë të paketës së mbikëqyrjes së përmbaruesve gjyqësorë nga ministria, me kompetenca të sakta dhe me tagra të kufizuara deri aty ku nuk ndërhyhet nga gjykata, ose ku nuk bie ndesh me rolin kontrollues të gjykatës; për përcaktimin e kompetencave më të zgjeruara ndaj Dhomës së Përmbaruesve Privatë, si dhe një proces disiplinor të bazuar në kriteret strikte dhe parime të të drejtave të njeriut, si komision menduam të ngremë një grup pune të përbërë nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, nga ekspertë të misionit EURALIUS, ku përveç ekspertëve që kanë punuar vazhdimisht, është kërkuar nga vetë EURALIUS-i, por edhe nga Dhoma e Përmbaruesve, që të jetë e domosdoshme prania e ekspertit ndërkombëtar Jos Uitdehaag, i cili

është edhe në cilësinë e anëtarit të bordit drejtues të Unionit Ndërkombëtar të Përmbarrimit. Ka qenë në grupin e punës edhe Ministria e Drejtësisë, patjetër. Pas një pune të madhe prej dhjetëra mbledhjesh të zhvilluara nga ky grup pune, pasi janë ezauruar dy tryeza të mëdha në kuadër të këtij procesi, një tryezë që më 28. 02. 2017, me praninë e Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Financave, Dhomës Kombëtare të Përmbarruesve gjyqësorë privatë, përmbarrues të ndryshëm, përfaqësues të shoqatës së bankave, përfaqësues të Bankës së Shqipërisë, përfaqësues të organizatave të shoqërisë civile dhe të ftuar të tjerë. E njëjta tryezë është përsëritur më 26.03.2019. Këto tryeza janë bazuar: e para, në draftin e prezantuar në Kuvend, e dyta, në një draft paraprak të punuar nga grupi i punës. Besoj se kemi arritur në një moment kulmor të punës së madhe të këtij grupi, por edhe të gjithë këtij procesi për këtë ligj, i cili, sikurse thashë, është ligji i fundit në paketën e profesioneve të lira brenda paktës së 27 ligjeve. Shpresojmë që sot të ecim më procesin e miratimit në parim.

Do të ftoj të gjithë anëtarët e komisionit (bëra edhe një ekspozë të gjerë për shkak të anëtarëve të rinj të nderuar në këtë komision, të cilëve u uroj suksese në punë) ta mbështesin dhe ta kalojnë sot në parim dhe në mbledhjet e ardhshme të diskutojmë nen për nen. Ne kemi një draft të rakorduar midis pjesës kryesore të aktorëve, propozuesve, ekspertëve. Ka disa modalitete, për të cilat nuk ka dakordësi midis Ministrisë së Drejtësisë dhe Dhomës së Përmbarruesve apo Dhomës dhe të gjithë grupit, apo midis Ministrisë e të gjithë grupit, por besoj se është bërë më e mira e mundshme dhe, sikurse e kam thënë, nuk ka asnjë akt perfekt, perfekt bëhet procesi. Nëse kemi bërë një proces shumë të mirë, jam i bindur se deri në fund të përmbylljes së këtij procesi nen për nen do të kemi mundësi të adresojmë edhe të gjitha shqetësime e Ministrisë së Drejtësisë apo të Dhomës së Përmbarruesve.

Ju faleminderit! Ju ftoj edhe një herë për ta mbështetur dhe për ta votuar në parim këtë projektligj!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Hyseni!

Siç e theksuat edhe ju, do të kemi prezantimin dhe miratimin në parim të këtij projektligji, pastaj në seancat e radhës do të kemi shqyrtimin dhe miratimin nen për nen.

Zoti Peçi, në emër të ekspertëve, kush do ta bëjë një prezantim të detajuar të këtij projektligji? Sigurisht, duam një prezantim në mënyrë të përmbledhur të projektligjit për qëllimin, misionin, por edhe risitë e tij.

Idlir Peçi – Faleminderit, zoti Manja!

Unë do të bëj një prezantim të ligjit. Pa dashur të përsërit ato që tha zoti Hyseni dhe zoti Uitdehaag, do të flasë për përputhshmërinë e këtij projektligji me standardet ndërkombëtare. Ndoshta për pjesët e tjera edhe ministria ka qëndrimin e saj.

Në fakt, siç e tha edhe zoti Hyseni, projektligji ka prekur disa hallka të fushës së veprimit të përmbauesve ose të ekzekutimit të vendimeve gjyqësore. Në këtë aspekt, problemet që ngriti zoti Hyseni janë përpjekur të adresohen nga grupi i punës. Është filluar që me fushën e zbatimit të projektligjit, duke e zgjeruar deri diku edhe fushën e veprimit të përmbauesve gjyqësorë privatë. Pra, përveç detyrës së tyre parësore, që është ekzekutimi i vendimeve gjyqësore, mund të kryejnë edhe disa aktivitete të tjera dytësore, për shembull të kryejnë njoftimin e akteve gjyqësore dhe të dokumenteve zyrtare apo mbledhjeve të detyrimeve financiare me mirëkuptim, me kërkesë të interesuarit personit fizik apo juridik. Gjithashtu, një nga problemet që është vënë re dhe që është ngritur edhe në grupin e punës është hyrja në profesion. Pra, është menduar të ketë një filtrim të hyrjes në profesion, duke pasur një trajnim fillestar të atyre personave, të cilët duan të hyjnë në profesionin e përmbauesit gjyqësor privat. Më tej, pas një trajnimit fillestar, do të bëjmë një praktikë dyvjeçare, më pas mund të kenë të drejtën për t'u emëruar nga ministri i Drejtësisë, si përmbaues gjyqësor privat. Në këtë aspekt është e nevojshme të ketë edhe një qendër të trajnimeve për përmbauesit gjyqësorë privatë, si për trajnimet fillestare apo edhe ato vazhduese. Prandaj është parashikuar edhe ngritja e qendrës kombëtare të trajnimeve për përmbauesit privatë, e cila organizohet dhe rregullohet më tej nga Dhoma e Përmbauesve.

Siç e tha edhe zoti Hyseni, ka një forcim të kompetencave të Dhomës dhe një plotësim të kuadrit ligjor, i cili bën të mundur organizimin dhe funksionimin e Dhomës në mënyrë më efikase, duke shpërndarë edhe kompetencat ndërmjet Ministrisë dhe Dhomës së Përmbauesve për sa i përket kontrollit të profesionit, pra parimi i kontrollit të brendshëm dhe kontrollit të jashtëm ndaj një profesioni të lirë. Në këtë aspekt është shumë e rëndësishme jo vetëm ajo që shkruhet në ligj, por edhe një marrëdhënie e vazhdueshme e mirë ndërmjet Ministrisë dhe Dhomës për sa i përket mirëpërcaktimit të kompetencave, të cilat janë edhe në projektligj.

Një fushë tjetër, ku është punuar, është organizimi i përmbauesve në zyra përmbaimore. Nëse dy apo më shumë përmbaues gjyqësorë privatë duan të organizohen në zyra përmbaimore, mund të organizohen në bazë të legjislacionit në fuqi për shoqëritë tregtare, kusht është që veprimtaria përmbaimore të jetë individuale, duke qenë se edhe certifikata është individuale.

Ka një përmirësim të kuadrit ligjor për regjistrat që mbahen nga Ministria e Drejtësisë, duke krijuar një kuadër më të detajuar për sa u përket detyrimeve qoftë të përmbauesve, qoftë të Ministrisë për të pasur një regjistër më transparent dhe më të detajuar që bën të mundur transparencën e profesionit, siç e tha edhe zoti Hyseni, që ka qenë një nga problemet kryesore që është vënë re në këtë sektor.

Është plotësuar kuadri ligjor edhe për kontrollin dhe mbikëqyrjen nga Ministria e Drejtësisë, duke forcuar nga njëra anë kompetencat e ministrisë, duke qenë se është një profesion, një funksion publik, i cili delegohet nga shteti te personat privatë. Por, ashtu siç e tha edhe zoti Hyseni, kontrolli i Ministrisë konsiston në përmbushjen formale të detyrimeve ligjore që përmbaruesit ligjorë kanë në ushtrimin e detyrave të tyre dhe mendojmë se nuk ndërhyjnë në ato aspekte procedurale, të cilat palët mund t'i kundërshtojnë në gjykatë.

Llogari bankare është një risi, e cila duhet të hapet nga çdo përmbarues gjyqësor privat. Kjo llogari përdoret vetëm për transaksione me kreditorët, pra është një llogari, e cila ndoshta hapet nga përmbaruesit privatë, por në parim u përket kreditorëve, sepse shumë parash që kalon në atë llogari është e destinuar për të paguar kreditorët. Vazhdueshmëria e ekzekutimit është një nga pikat kyçe, ku është punuar. Në këtë aspekt, nëse një përmbarues për arsye të ndryshme nuk vazhdon më ekzekutimin e një çështjeje ose një dosjeje, atëherë është menduar të jetë figura e përmbaruesit zëvendësues, i cili vazhdon aty ku e ka lënë përmbaruesi i parë. Ekzekutimi vazhdon, me të gjitha të drejtat dhe detyrimet që ka pasur përmbaruesi i parë, pa krijuar një ngërç në ekzekutimin e çështjes.

I fundit, por jo më pak i rëndësishëm, është procesi disiplinor. Ky proces është shumë i detajuar për disa arsye. Arsyeja më kryesore është mbrojtja e përmbaruesve gjyqësorë, garancitë që i ofron ky proces, duke qenë se në radhë të parë kemi një ndarje të sanksionimit nga hetimi, pra standardi kryesor ndërkombëtar që ai që heton nuk mund të sanksionojë është në përmbushje të nenit 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, të jurisprudencës së Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, pra procesi disiplinor kërkon një sanksionues të pavarur nga ai që bën hetimin administrativ apo disiplinor. Në këtë aspekt ka një ndarje. Është krijuar bordi i disiplinës, i cili është i pavarur. Procesi disiplinor është i detajuar, duke u ofruar shumë më tepër garanci dhe shumë të drejta përmbaruesve, të cilat nuk i kanë në procesin aktual. Për këtë arsye mendoj se kemi arritur më të mirën, duke ofruar në një anën përmbushjen e standardeve ndërkombëtare, në anën tjetër u ofrohen më tepër garanci përmbaruesve gjyqësorë për sa i përket procesit disiplinor.

Kolegu Uitdehaag do të bëjë një pasqyrë shumë të shkurtër të standardeve ndërkombëtare.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Peçi!

Fjalën e ka eksperti ndërkombëtar, Jos Uitdehaag për të bërë një prezantim të përafrimit të këtij projektligji me standardet europiane.

Jos Uitdehaag – Faleminderit shumë!

Mendoj se pjesa më e madhe u tha nga zoti Peçi. Më së shumti do të përqendrohem të problematikave që lidhen me standardet ndërkombëtare. Kur flasim për standarde ndërkombëtare, u referohemi kryesisht rekomandimeve të nenit 17 të vitit 2003 të konventës europiane. Në këtë kuadër, përqendrohem kryesisht te rekomandimet që janë dhënë nga Këshilli i Europës në vitin 2009, ku fokusi bie tek efikasiteti.

Së fundi, janë standardet ndërkombëtare, që shkojnë për zbatimin e vendimeve gjyqësore, të cilat vijnë nga Unioni Ndërkombëtar i Përmbauesve.

Duke pasur parasysh punën që po bëhet për procesin e hyrjes në Bashkimin Europian, jemi fokusuar te këto parime dhe rekomandime, që të jemi në përputhje me standardet ndërkombëtare për sa i përket çështjes së përmbauesve.

Ashtu siç e përmendi edhe zoti Peçi, tashmë kemi një pozicion të ri për sa i përket fushës së veprimit, ku fusha e veprimit për përmbauesit nuk është e kufizuar vetëm te pjesa e zbatimit të vendimeve gjyqësore, por edhe tek aktivitetet e tjera, si çështja e dokumentacioneve, e njoftimeve, mbledhja e borxheve e të tjera.

Gjithashtu, është shumë e rëndësishme që të garantohet bashkëpunimi midis palëve. Për sa i përket përmbushjes së detyrimeve, kur vjen puna te bashkëpunimi midis palëve, bëhet fjalë për kreditorët dhe debitorët.

Për sa i përket figurës së përmbauesit, sipas standardeve ndërkombëtare, ajo është një figurë me moral të lartë dhe duhet të ketë njohje të thellë të ligjit. Në krahasim edhe me ligjin aktual, vihet re se është sjellë një risi për sa i përket trajtimit fillestar dhe atij të vazhdueshëm.

Gjithashtu, një aktor tjetër shumë i rëndësishëm është dhoma, e cila ka njohuritë e duhura dhe të plota për sa i përket zbatimit. Ajo ka njohuritë dhe kompetencat e duhura për anën teorike, ashtu edhe praktike dhe në të gjitha rekomandimet që kam dhënë e gjej të hartuar mjaft mirë këtë pozicion të dhomës.

Në kuadër të standardeve ndërkombëtare, parashikohet se përmbauesit, të cilët vendosen të funksionojnë në mënyrë të pavarur, pavarësisht se janë struktura të pavarura, duhet të jenë nën organizimin e një organizate ose një dhome kombëtare. Kjo shkon përkrah të gjitha rekomandimeve ndërkombëtare.

Gjithashtu, në kuadër të këtyre standardeve ndërkombëtare, duhet të keni parasysh edhe delegimin e pushtetit shtetëror që kalohet në dorë të përmbauesve. Me delegimin e këtyre përgjegjësi, do të thotë se ata kanë disa të drejta, por në të njëjtën kohë kanë edhe disa detyrime.

Për sa i përket të drejtave, së pari, kemi pjesën e autoritetit që kanë ata për të bashkëpunuar, për shembull, për të dhënë informacione për sa i përket debitorit.

Në të njëjtën kohë për sa u përket detyrimeve, është aspekti profesional, i cili është i kontrolluar. Kontrollon se si profesioni ose detyrat e këtij profesioni janë performuar dhe këtë e përmendi edhe zoti Peçi pak më herët, pra për sa i përket kontrollit të brendshëm dhe të jashtëm që ushtrohet.

Në këtë kuadër mbetemi tek ajo që e quajtmë mbikëqyrja për aspektin profesional së brendshmi, por gjithashtu edhe së jashtmi nga ai organ i jashtëm që realizon këtë kontroll, që në rastin e Shqipërisë do të jetë Ministria e Drejtësisë.

Gjithashtu, këtu me rëndësi janë edhe përfitimet disiplinore që u përmendën pak më herët dhe vijnë si rezultat i atij kontrolli që u përmend dhe janë në kuadër dhe në zbatim të nenit 6 të konventës europiane. Gjykata Europiane është shumë e qartë kur vjen në këtë aspekt, është e gjitha në kuadrin e nenit 6 të konventës europiane për një gjykim të drejtë. Në kuadër të këtij gjykimi të drejtë mendojmë se procedimet disiplinore janë me vend në këtë rast. Përsëri në këtë linjë palët duhet të kenë të drejtën për një gjykim të paanshëm, të pavarur, gjithashtu kanë të drejtën të dëgjojnë vendimet që gjithçka të jetë publike dhe ata të marrin njoftime për çdo vendim të dhënë.

Gjithashtu, është siguruar që personat që do të hetojnë çështjen, ashtu siç e përmendi edhe zoti Peçi, nuk do të jenë ata që do të marrin vendimin për këtë çështje.

Për sa i përket çështjes së delegimit të pushtetit shtetëror, në këtë kuadër është vendosur edhe çelja e llogarisë bankare, që u përmend pak më herët. Kjo vjen edhe në kuadër të rekomandimeve të CEPEJ-it, që do të jetë një llogari bankare e dedikuar.

Ndryshe nga ligji aktual, ka më shumë detajime për sa i përket kësaj llogarie bankare, tashmë diçka është më e qartë, dihet dhe do të bëhet publike statusi i pronarit të llogarisë bankare, do të dihet si lëvizin llogaritë bankare brenda saj, çfarë ndodh me të, statusin e kësaj llogarie bankare dhe depozitat që kalojnë aty. Çfarë është sjellë e re me ndryshimet brenda ligjit? Është parashikimi se çfarë do të ndodhë me çështjen dhe si do të procedohet në raste pezullimi ose pushimi nga ana e përmbauesit në aktivitetin e tij.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Uitdehaag!

Nga Ministria e Drejtësisë, fjalën e ka zonja Treska.

Katrin Treska - Faleminderit!

Varianti i projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10031, datë 11.12.2008 “Për shërbimin përmbauesor gjyqësor privat”, të ndryshuar”, shtruar për diskutim në tryezën e konsultimit të organizuar në muajin mars, është vlerësuar me vëmendje nga strukturat përgjegjëse të ministrisë dhe është parë nën këndvështrimin e adresimit në të dhe të

atyre problematikave që kemi ndeshur këto vite për sa i takon shërbimit përmbartimor gjyqësor privat. Ministria e Drejtësisë ka qenë pjesëmarrëse në disa takime radhë me ekspertët e EURALIUS-it dhe këshilltarët e Komisionit të Ligjeve për të diskutuar për draftin.

Në vitin 2018 është e vërtetë që Ministria e Drejtësisë ka përcjellë edhe propozimet e saj mbi variantin fillestar të depozituar, që ka qenë produkt i grupeve të punës me ekspertë në kuadër të reformës në sistemin e drejtësisë. Duke qenë se sot diskutimi është në parim, duam të theksojmë disa prej çështjeve që, në vlerësimin tonë, janë të rëndësishme dhe kërkojnë diskutim të kujdesshëm gjatë shqyrtimit nën për nën, duke mbajtur në konsideratë edhe propozimet e misionit të EURALIUS-it apo diskutimet që kemi pasur në tryezat paraprake të punës.

Lidhur me hyrjen në profesion, jemi dakord në parim me rolin e ri të ndihmës përmbartuesit dhe nënvizojmë faktin që është vetëm një rol ose detyrë e re dhe jo një figurë e veçantë apo procedurale.

Ndihmës përmbartuesi do të jetë jurist, i cili asiston, por nuk kryen veprime procedurale përmbartimore, por do të ketë trajnim përmbartimor përkatës, fakt i cili do të rrisë cilësinë e shërbimit përmbartimor të ofruar, rritjen e sofistikimit të organizimit të zyrave përmbartimore, specializimin e shërbimit të ofruar nga subjektet përmbartimore, persona fizikë apo shoqëritë përmbartimore private. Ky rol i ri i shtuar që nuk i bashkëngjitet përmbartuesit gjyqësor privat, gjithashtu është në funksion të promovimit të shërbimit përmbartimor privat, si një mundësi zgjedhjeje për juristët e rinj, në lidhje me karrierën në vijim, duke i dhënë kredite promovime edhe vetë shërbimit përmbartimor në tërësi.

Në vlerësimin tonë ndihmës përmbartuesi për t'u bërë përmbartues duhet të japë provimin e certifikimit në fund të periudhës së përfundimit të stazhit praktik. Jemi dakord në parim me ngritjen e shkollës apo qendrës së trajnimeve pranë dhomës kombëtare, por lidhur me modalitetet e hyrjes në qendrën e trajnimeve kemi vërejtjet tona, që do t'i parashtrojmë gjatë diskutimit nën për nën.

Lidhur me procedimin disiplinor, projektligji ndryshon përbërjen e komisionit disiplinor duke synuar ngritjen e një komisioni, anëtarët e të cilit kanë mandat. Ky model nuk gjendet në këtë formë në asnjë nga shtetet që janë studiuar paraprakisht nga Ministria e Drejtësisë. Për shembull, në Itali përmbartuesi gjyqësor privat i nënshtrohet procedimit disiplinor nga kryetari i Gjykatë së Apelit apo juridiksionit të zakonshëm, ku ai ushtron veprimtarinë e tij, pas vendimit të arsyetuar nga komisioni që ngrihet pranë çdo gjykatë. Në Francë përgjegjësia profesionale dhe etike trajtohen nga sanksione disiplinore që janë të përcaktuara në ligj. Përmbartuesi u nënshtrohet seancave dëgjimore për shkelje të disiplinës të

organizuara midis dhomave rajonale dhe departamenteve të dhomës, në të cilat ata praktikojnë profesionin. Përbërja e trupës që mban seancat përbëhet nga përmbaues të zgjedhur për të shqyrtuar masën. Në varësi të llojit të shkeljes aplikohen masat e përcaktuara në ligj. Pra, procedimi disiplinor, sipas modelit francez edhe modelit holandez, sugjeron kontrollin e brendshëm të Dhomës, ku komisioni disiplinor përbëhet vetëm nga përmbaues. Në Gjermani përgjegjësitë e përmbauesve, duke qenë se konsiderohen si funksionarë publikë, janë të parashikuara nga Kodi Civil gjerman në kreun “Përgjegjësitë për shkeljet e detyrave zyrtare”. Lidhur me modelet e mësipërme, për sa i përket procedimit disiplinor, vlerësojmë se asnjë prej tyre nuk mund të përshtatet. Theksoj faktin se Ministria e Drejtësisë duhet të luajë një rol kyç në rregullimin e sistemit të ofrimit të këtij shërbimi dhe të garantojë ofrimin e tij në mënyrë të pavarur me profesionalizëm dhe kompetencë, duke zbatuar Kushtetutën, ligjet dhe rregullat e tjera të detyrueshme. Ndaj procedimi disiplinor nuk mund të lihet vetëm në dorë të përmbauesit privat, sipas modelit holandez dhe francez. Gjithashtu, nuk kemi rrethana për të pranuar modelin italian, i cili do të mbingarkonte sistemin gjyqësor. Nuk duhet anashkaluar fakti se këto vende kanë një nivel të lartë të organizmit të brendshëm, ku përmbauesit jo vetëm kontrollohen tërësisht nga komisioni, por edhe subvencionohen nga Dhoma për problemet e ushtrimit të detyrës dhe anës financiare, por në këto vende bëhet fjalë për dhoma me numër të lartë përmbauesish nga 800-1000 përmbaues, ku edhe të ardhurat janë të larta, ndërkohë që modeli aktual që ka ligji në fuqi i referohet atij bavarez, i cili që kur u hartua për herë të parë është llogaritur për një numër relativisht të vogël subjektesh, rreth 100, sipas numrit të popullsisë dhe shtrirjes gjeografike. Sot kemi rreth 160 përmbaues dhe mbulimi i aktivitetit të Dhomës, përfshirë komisionin disiplinor, i cili paguhet nga të ardhurat e vet Dhomës, mund të dështojë në misionin e saj nëse shtohet numri, sipas propozimit të projektligjit dhe mënyrës së funksionimit, duke e kthyer komisionin disiplinor në një organ me mandat 4-vjeçar.

Në vlerësimin tonë, ndryshimi i mënyrës së procedimit disiplinor nuk vlerësohet me vend. Praktika ka treguar se procedimi disiplinor ka funksionuar më së miri në rastin e përmbaimit gjyqësor privat, për më tepër në kushtet aktuale, kur paralelisht po ecën procesi...

Në praktikë, procedimet disiplinore tregojnë se për 4 vjet kemi pasur rreth 42 procedime.

Lidhur me kreun e ushtrimit të kontrollit në tërësi, është një kre i ri që shtohet, kreu 8\1, me rreth 30 dispozita, për të cilin kemi vërejtje për mënyrën e detajuar se si është parashikuar zhvillimi i hetimit administrativ për disa arsye.

Së pari, përmbajtja dhe mënyra e shkrimit të dispozitave nuk është në përputhje me rregullat e teknikës legislative, por besoj se janë elemente, të cilat do të vlerësohen gjatë shqyrtimit nën për nen.

Projektligji parashikon disa dispozita, si: ankesat, fillimin e hetimeve kryesisht, shtimin ose ndryshimin e objektit të hetimit, pezullimin e hetimeve, bashkimin e hetimeve, kërkesat për marrje në pyetje, kërkesat në lidhje me mbledhjen e provave nga institucionet e tjera, dokumentacioni i hetimit e të tjerë. Të gjitha këto dispozita kanë parashikime që normojnë veprimtarinë administrative të Ministrisë së Drejtësisë gjatë hetimit disiplinor. Të gjitha përcaktimet e bëra në to janë tashmë të rregulluara në Kodin e Procedurave Administrative që gjejnë zbatim direkt. Sjellim në vëmendjen tuaj se Sigma në vazhdimësi, edhe në raportet e Public Administration Reforme Special Group Meeting, në takimin e bërë javën e kaluar, kërkoi ndjekjen me parësi të procesit të përafrimit të legjislacionit sektorial me Kodin e Procedurave Administrative dhe vë theksin te fakti që përmes amendimeve duhen eliminuar mbivendosjet e rregullave për të zbatuar Kodin dhe duhet treguar kujdes për këtë qëllim edhe në miratimin e ligjeve të reja. Në rastin konkret, kemi të bëjmë me një procedurë specifike kontrolli për një pushtet të deleguar, por 30 dispozitat për normimin e veprimtarisë së ministrisë, kur ministria i nënshtrohet zbatimit të Kodit, jo vetëm që nuk ofrojnë ndonjë garanci më shumë, por nuk janë në përputhje me vetë qëllimin dhe objektin e ligjit.

Projektligji parashikon edhe marrjen e ekspertëve të pavarur për ushtrimin e kontroleve. Në vlerësimin tonë, parashikimi i ekspertëve të pavarur është i panevojshëm dhe aplikimi i kësaj dispozite në praktikë do të jetë i vështirë, sepse ministria ka strukturë të dedikuar me nëpunës, të cilët duhet të jenë të specializuar në ushtrimin e inspektimeve të përmbaruesve. Nëse lind nevoja e marrjes së ekspertëve gjatë kontrollit, mund të aplikohen rregullat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, pa qenë nevoja për parashikim të posaçëm në projektligj. Vështirësi do të paraqesë edhe përpilimi i listës, përcaktimi i tarifave dhe shpërblimit, gjetja e fondeve dhe mbështetja ligjore për përzgjedhjen dhe kontraktimin e tyre, pasi nga ana administrative ligji kërkon që përzgjedhja dhe kontraktimi i një shërbimi të bëhet me prokurim publik. Në fund është tërësisht e paqartë se cila do të jetë vlera e mendimit të ekspertit në përpilimin e një raporti të brendshëm të hetimit dhe marrjes së masës.

Çështja e fundit, element i rëndësishëm i projektligjit të propozuar, që zgjidh në mënyrë përfundimtare problematikat që derivojnë prej ofrimit të shërbimit përmbarimor privat deri sot nga ana e subjekteve tregtare përmbarimore, duke e vendosur këtë të fundit në funksion të përmbushjes së plotë të misionit publik dhe përmbarimor është vendosja e detyrimit taksativ dhe ofrimit të këtij shërbimi nga shoqëri përmbarimore, që mund të krijohen vetëm nga

përmbaruesit e certifikuar nga ministri i Drejtësisë, i cili do të miratojë edhe krijimin e këtyre shoqërive. Në këtë kontekst projektligji duhet të sanksionojë qartë mundësinë e ofrimit të shërbimit përmbarimor nëpërmjet një subjekti tregtar, ku ortakët, aksionarët, administratorët dhe të punësuarit duhet të kenë cilësinë e përmbaruesit të certifikuar. Kjo garanci ligjore disiplinon përfundimisht mënyrën e ofrimit të shërbimit përmbarimor prej subjekteve tregtare, duke vendosur në plan të parë vetëm shërbimin publik të ekzekutimit të titujve ekzekutiv. Komentet e tjera më të detajuara do t'i japim kur projektligji të diskutohet nen për nen.

Spartak Braho – Katrin, ligji aktual ka 57-58 nene dhe ne këtu ndryshojmë 37 nene, që do të thotë se nuk bëhet më fjalë për ndryshime, por për një ligj të ri. Pse keni qëndruar pasiv deri tani? Ligji ekzistues ose nuk bën më, ose është problematik në zbatimin e tij dhe na detyron ne që të bëjmë 37 ndryshime, që do të thotë gati 70%. Unë mendoj se kjo duhet parë dhe të shkojmë te një ligj integral, i plotë dhe pa ndryshime.

Ulsi Manja – Zoti Braho, faleminderit!

Unë dua një mendim të shkurtër lidhur me këtë nga përfaqësuesit e Dhomës, pastaj të kalojmë te pyetje dhe diskutimet e kolegëve.

Tedi Malaveci – Faleminderit, zoti kryetar për ftesën dhe për fjalën!

Ne kemi menduar gjithmonë se ky projektligj duhet të japë një kontribut domethënës në paketën e 27 projektligjeve të tjera. Kjo jo për faktin që u la për në fund, por se është një ligj shumë i rëndësishëm në ngrehinën e re të institucioneve të sistemit të drejtësisë.

Roli i përmbarimit në sistemin e drejtësisë tashmë dihet dhe nuk po e komentoj, sepse është përmendur aq shpesh, sa që mendimet për përmbarimin dhe ekzekutimin e vendimeve gjyqësore sot janë deviza të gjithëpranuara. Është e vërtetë që kohët e fundit u përfshimë në një debat për mënyrën e punës apo draftimit të këtij ligji organik që na prek drejtpërsëdrejti, por duhet të na mirëkuptoni, sepse ky debat lindi vetëm nga angazhimi ynë shumë serioz këta dy vjetët e fundit lidhur me këtë projektligj, që papritur në 6-mujorin e fundit nuk gjeti bashkëpunimin e duhur nga ekspertët që u morën me këtë draft. Gjithsesi, duhet t'ju bëj me dije se merakun apo qëllimin ynë i vetëm në të gjithë këtë proces amendues nuk kanë qenë dispozita konkrete apo futje elementesh ligjore që na duhen apo na shkojnë për shtat, apo që do të duhet t'i implementojmë me doemos, por thjesht dhe vetëm vendosja e një kuadri ligjor, që promovon këtë shërbim në tërësi dhe konsolidon përmbarimin privat apo përmbaruesin privat si titullar të këtij shërbimi në veçanti.

Në respekt të punës së kryer nga ekspertët shqiptarë dhe të huaj, dua të prek disa prej avantazheve apo risive të këtij projektligji.

Së pari, koncepti i mbështetjes profesionale ligjore e përmbauesve gjyqësorë nëpërmjet ndihmës së përmbauesit është një risi, që ne e mbështesim. Gjithashtu, edhe Qendra Kombëtare e Trajnimeve, e trajtuar gjerësisht në projekt, të cilën kemi propozuar të quhet Shkolla Kombëtare e Përmbaimit, është një masë konkrete, që ne e përkrahim në drejtim të rritjes së integritetit dhe performancës profesionale të përmbauesit privat, e cila ka qenë në qendër të vëmendjes në mjaft debate, ku përfshihet përmbaimit dhe veprimet përmbaimore, që shpesh janë bërë edhe publike. Ne mendojmë që kjo qendër do të shërbejë si një guidë orientuese për të gjithë ecurinë profesionale të subjekteve të këtij shërbimi.

Nenin 42\1, i cili i referohet transferimit të çështjeve përmbaimore apo kalimit të veprimeve procedurale nga njëri subjekt në tjetrin, e shohim tashmë të rregulluar qartë në referim të kontekstit aktual të zhvillimit të shërbimit tonë.

Risia më lavdëruese e këtij projektligji është sjellja e nenit 46\1 “Kërkesa për ndihmën e Policisë së Shtetit, ku më në fund përmbauesit do të gjejnë të sanksionuar në ligj një lloj mbështetjeje të Policisë së Shtetit, e cila ka për detyrë jo vetëm të ndihmojë në ekzekutim, por edhe kur emergjenca e ndihmës do të kërkohet verbalisht për ngjarjet që rrezikojnë jetën, shëndetin, por edhe vetë pronën e përmbauesit.

Dua të them shumë shkurt diçka lidhur me kontestin që kemi ndaj këtij projektligji.

Së pari, e përmendi edhe zoti Braho, ekspertët e huaj që kanë asistuar në hartimin e ligjit aktual nr. 131, të cilët kanë qenë ekspertë të EURALIS-it, propozuan një ligj me 57 nene, ndërsa drafti aktual ka parashikuar për të shtuar edhe 38 nene të tjera dhe ka ndryshuar 27 aktualë, pa llogaritur paragrafë të neneve aktuale. Draftit i mungojnë një sërë dispozitash tranzitore, që do të ndihmojnë në implementimin e ndryshimeve të parashikuara që do të kryhen.

Gjithashtu, e kemi përmendur, shkruar dhe insistuar edhe më parë që drafti, në opinionin tonë, është shumë i ngarkuar me dispozita, paragrafë, pika të stërzgjatura jashtë çdo mundësie për t’u rregulluar nga pikëpamja e teknikës legjislative, ndërkohë mendojmë se ligji duhet të jetë i qartë, i thjeshtë, i aplikueshëm, i kuptueshëm si në shprehje, ashtu edhe në mënyrën sesi ndërthuret me akte të tjera ligjore dhe nënligjore. Pra, i mungon qartë saktësia në mënyrën sesi është organizuar.

Duhet të theksojmë faktin që ky është një ligj organik dhe jo procedural. Me të drejtë kemi debatuar edhe me ekspertët e huaj që të gjitha ligjet që na referohen si krahasuese janë ligje të plota, që përfshijnë organizim dhe procedurë, pra janë kode përmbaimore, ndërsa ky që po diskutojmë është thjesht një ligj organik, i cili merret me organizimin e shërbimit përmbaimit gjyqësor privat. Ne duhet ta kontestojmë që nga përkufizimi. Pse duhet të jenë

gjithë këto përkufizime dhe në këtë mënyrë gjejmë edhe parazitizma, si emërtesa “debitori”, që nuk gjendet fare në gjithë ligjin dhe nuk ka pse të jetë.

Ne jemi duke folur vetëm për përmbaruesit gjyqësorë privatë, të drejtat dhe detyrimet përballë palëve kërkuese, kreditorëve, dhe palëve ndaj të cilave ndikon ekzekutimi, që mund të jenë palët e treta. Pra, nuk ka arsye të futen terma të tillë, si “veprimtari përmbarimor”, “procedurë përmbarimor”, për sa kohë që kjo e dyta, sepse procedura parashikohet në Kodin e Procedurës.

Veprimtaria është një term që nuk ka nevojë të definohet, as Dhoma dhe ministria, sepse dihet se çfarë janë, qoftë edhe lista e përmbaruesve, sepse janë terma parazitare në opinionin tonë. Nëse do të fillojmë të shpjegojmë çdo fjalë të shqipes, atëherë i bie të përkufizojmë edhe fjalët “subjekt”, “certifikatë”, “shtetas” e të tjera. Ne jemi në kushtet kur nuk ka nevojë për emërtesa, përkufizime dhe terminologji të kota brenda një ligji të thjeshtë, i cili është ligj organik.

Më parë dëgjova edhe përfaqësuesin e Euralius-it, i cili komentoi dhe mbështeti definicionin e Zyrës së Përmbarimit, ashtu sikurse edhe zëvendëspërmbaruesi privat. Zëvendëspërmbaruesi nuk mund të konsiderohet fare për sa kohë që nuk parashikohet si organik procedural në Kodin e Procedurës Civile, ndërsa sa i takon Zyrës së Përmbarimit nuk jemi të qartë se çfarë është kjo zyrë, sepse në Kodin e Procedurës nuk përmendet fare si nocion dhe nuk ka arsye pse të ketë zyrë përmbarimi, sepse ne nuk jemi shërbim avokatie...

(Diskutime pa mikrofon)

Ulsi Manja – Sot do të diskutojmë vetëm në parim. A jeni ju dakord në parim me ligjin? Ky është thelbi. Sa u takon teknikaliteteve nën për nen dhe sugjerimeve, do të kemi kohë t’i diskutojmë gjerësisht.

Mund të vazhdoni, zoti Malaveci.

Tedi Malaveci – Në draftin e paraqitur shohim se hartuesit, një pjesë të mirë e tyre, te ky draft i kanë kushtuar vëmendje bordi disiplinor apo komisionit disiplinor. Ne shohim se të dyja emërtesat janë referuar dhe mendoj se ky do të jetë një gabim teknik. Sa i takon shtimit të një kapitulli të tërë, për komisionin disiplinor, ky është një kapitull aq sa është i gjithë ligji aktual. Ne e shohim këtë si një arsye represive për ta vendosur këtë shërbim nën këtë lloj fokusi, ndërkohë që ne jemi vetëm një pjesë e shërbimit përmbarimor shqiptar, pasi jemi rivalët dhe bashkëpunëtorët e shërbimit shtetëror. Shërbimi Përmbarimor ka një ligj të paprekur që nga viti 2001 dhe ky lloj përqendrimi apo komisionimi ndaj Përmbarimit Gjyqësor Privat na duket i pakuptimtë, gjithsesi nëse ju do t’i konsideroni opinionet tona, të cilat ua jemi dërguar me shkrim do t’ju ishim shumë mirënjohës.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Malaveci!

A ka pyetje nga kolegët për projektligjin?

Fjalën e kanë përfaqësuesit e Ministrisë së Drejtësisë.

Katrin Treska – Ne jemi dakord me projektligjin, për të cilin është punuar gati 2 vjet. Ne thjesht duam që gjatë diskutimit nën ato që janë çështje problematike duhet t'i parashtrojmë.

Ulsi Manja – Dakord.

Fjalën e ka kërkuar për pyetje, zoti Zeneli.

Alban Zeneli – Faleminderit, zoti kryetar!

Ne jemi mbledhur sot këtu për të diskutuar në parim një ndër projektligjet për përmbaruesit gjyqësorë privatë. Nga kontaktet që kam pasur me grupet e interesit të përmbaruesve gjyqësorë privatë asnjë nga vërejtjet dhe sugjerimet e këtyre grupeve nuk janë pasqyruar në këtë projektligj shumë të rëndësishëm të reformës në drejtësi. Një prej tyre është edhe rasti i pezullimit të licencës së përmbaruesve gjyqësorë privatë, sepse nuk është përcaktuar se kush dhe sa hallka do ta bëjnë këtë lloj pezullimi. Veprimtaria e përmbaruesve gjyqësorë privatë nuk duhet të jetë e kufizuar siç është e përcaktuar në këtë projektligj. Për mendimin tim, por edhe të grupeve të interesit të përmbaruesve gjyqësorë privatë, duhet të ishte përcaktuar mirë mandati i Dhomës në të cilën bëjnë pjesë të gjithë përmbaruesit gjyqësorë privatë. Krijimi i hallkave të tepërta të kontrollit për përmbaruesit gjyqësorë privatë nuk jep atë perceptimin që qytetarët shqiptarë kanë për gjithë paketën e reformës në drejtësi. Gjithmonë krijimi i hallkave të tepërta ka treguar gjithnjë e më shumë se ky proces bëhet korrupsiv, i gjatë dhe i vështirë.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Zeneli!

Fjala e zotit Zeneli përfshinte pyetje dhe diskutime në të njëjtën kohë.

Fjalën e ka zonja Hysi.

Vasilika Hysi – Faleminderit, zoti kryetar!

Falënderoj të gjithë përfaqësuesit, ekspertët e Dhomës...

Ulsi Manja – Më falni, zonja Hysi, por do t'ju kërkoja ekspertëve që kanë punuar me ligjin të mbajnë shënim pyetjet dhe të japin më pas përgjigje.

Vasilika Hysi – Më vjen mirë që projektligji pas një procesi konsultimi për gati 3 vjet erdhi në fazën e diskutimit dhe të kalimit nën për nën dhe më pas t'i përcillet seancës plenare. Në legjislaturën e kaluar kam pasur mundësinë të isha relatore dhe për këtë arsye kam punuar me ekspertët, si dhe ka pasur shumë diskutime, komente dhe rekomandime.

Pyetja e parë: A është marrë në konsideratë gjithë procesi konsultimit që ka nisur që në vitin 2016? A i kanë qëndruar variantit të diskutimeve që është bërë në atë kohë apo ka ndryshime?

E dyta. Një nga shqetësimet që ne kemi hasur dhe për të cilin jemi dëshmitarë është raporti midis ekzekutimeve që bëjnë përmbaruesit privatë dhe përmbaruesit shtetërorë. Shumë çështje që lidhen me konfliktet në familje, si pensionet ushqimore, çështje që lindin pas divorcit, nuk shoh të merren përmbaruesit privatë me to, por me aq sa kuptoj gjithçka u lihet përmbaruesve shtetërorë. Përmbaruesit privatë nuk janë vetëm për të bërë para dhe për ta konsideruar veten si shërbim, meqenëse janë përmbarues privatë, sepse ata ushtrojnë disa funksione që janë shumë të rëndësishme. Dua në di se në çfarë raporti qëndron ngarkesa e punës ose volumi i çështjeve që mund të përzgjedhin përmbaruesit privatë në raport me përmbaruesit e shtetit?

E treta. Lidhur me trajtimin e grupeve të veçanta, siç mund të jenë fëmijët, viktimat e dhunës në familje ose kategori të tjera që janë të marginalizuara, si është rregulluar ai shqetësim, të cilin e kam ngritur edhe më parë, roli i psikologëve dhe i profesionistëve të tjerë për të bërë ekzekutim të vendimeve në përputhje me standardet, duke pasur parasysh interesin më të lartë të fëmijës, interesin më të lartë të viktimës, proporcionalitetin për të mos parë ato situata që janë vërtet të dhimbshme dhe që nuk shkojnë për shtat, pavarësisht përfitimit që mund të ketë një përmbarues nga pikëpamja financiare apo detyrimi që ka për të ekzekutuar një vendim?

Kjo është një çështje, në qoftë se ju kujtohet, i nderuar ekspert, që e kemi kërkuar gjatë gjithë periudhës së konsultimeve që kemi bërë për këtë projektligj.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Zoti Shameti e ka fjalën për procedurë.

Adnor Shameti – Faleminderit, zoti kryetar!

Duke vlerësuar të gjitha ndërhyrjet e bëra nga ana e kolegëve të nderuar, si për pyetjet, edhe për sqarimet, do të doja t'ju tërhiqja vëmendjen në lidhje me diskutimin e sotëm. Pra, të gjitha ndërhyrjet dhe gjetjet që kolegët e nderuar të komisionit kanë ngritur sot nuk i takojmë miratimit në parim të projektligjit, prandaj do të doja të rezervoja të drejtën që të gjitha këto ndërhyrje, gjetje t'i takojnë seancës që do të bëhet për miratimin nen për nen të projektligjit dhe në këto kushte ta miratojmë në parim projektligjin.

Faleminderit!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Shameti!

Ne sot po diskutojmë projektligjin në parim, prandaj pyetjet e kolegëve duhet të fokusohen në diskutimin në parim në funksion të çështjeve parimore që kanë lidhje me projektligjin. Jam dakord me sugjerimin tuaj dhe me vërejtjen që të jemi më operativë.

Fjalën e ka zoti Peçi, në lidhje me pyetjet e koleges Hysi, si dhe shqetësimin e zotit Zeneli. Do të doja një përgjigje në parim nëse do të keni.

Idlir Peçi - Po e filloj me pyetjet e zonjës Hysi. Është e vërtetë që ka pasur një proces pothuajse 3-vjeçar dhe gjatë kësaj kohe është bërë një punë shumë e madhe për përpilimin e këtij drafti që do diskutohet para jush. Gjithashtu, të gjitha ndërhyrjet që janë bërë nga grupet e interesit dhe ekspertët janë marrë parasysh dhe në disa momente ne kemi dalë edhe me dy variante sa u takon neneve të ndryshme dhe në fund fare është bërë një zgjedhje apo preferencë për një variant të caktuar. Pra, dua t'ju them se i kemi marrë parasysh aq sa kemi pasur mundësi.

Si përfaqësues i Euraliusit, mund t'ju them se ky është një projektligj ku i gjithë procesi ka qenë ezaures dhe për këtë arsye e mbështesim në parim. Variacioni i parë ka ndryshime, sepse është një proces i gjatë 3-vjeçar dhe patjetër që do të ketë ndryshime, si dhe për arsen se ka pasur shumë diskutime dhe debate.

Sa i takon asaj që ngriti zonja Hysi, për personat në nevojë, në projektligj ka dispozita në të cilat nuk mund të refuzohet ekzekutimi i çështjeve dhe trajtimi financiar i tyre. Sa i takon rolit të viktimës apo të psikologut në procesin e ekzekutimit, nuk ka dispozita, kjo për arsye se roli i psikologut duhet më shumë në momentin e shqyrtimit gjyqësor. Megjithatë, të gjitha këto çështje mund t'i shohim më mirë gjatë shqyrtimit nen për nen.

Sa i takon pyetjes së zotit Zeneli, për ngarkesën, kjo lidhet me shqetësimet që ka pasur edhe Dhoma. Mendoj se po të përgjigjem do të përsëris të njëjtat gjëra që tha edhe përfaqësuesi i Dhomës. Ju kërkoj ndjesë nëse e kam kuptuar gabim.

Ulsi Manja – Po, zoti Zeneli.

Alban Zeneli – Unë ju dëgjova me vëmendje, sepse edhe përfaqësuesit e Dhomës kishin pak a shumë të njëjtat vërejtje. Përfaqësuesja e Ministrisë së Drejtësisë na dha disa shembuj të shteteve si Franca, Italia apo Gjermania, ku na treguan se cilat ishin institucionet për pezullimin e licencës së përmbauesve privatë gjyqësorë. Me sa mbaj mend unë, tha se ne nuk mund ta bëjmë dot siç e bën Franca apo Italia. Për mua ky argument nuk është shumë bindës, sepse, në fund të fundit, është gjyqësori ai që vendos se sa i drejtë është vendimi apo puna e një përmbauesi gjyqësor privat.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Zeneli.

Po, zoti Uitdehaag.

Katrin Treska – A mund të bëj një saktësim, ju lutem?

Unë mendoj se më keqkuptuat kur përmenda shembullin e Francës, ku procedimi disiplinor dhe masat merreshin nga vetë radhët e përmbaruesve. Ky është qëndrimi i Ministrisë së Drejtësisë dhe thamë se nuk ishin kushtet për ta lënë në dorë të përmbaruesve marrjen e masave disiplinore në radhët e tyre.

Ulsi Manja – Faleminderit, zonja Treska!

Alban Zeneli – Nuk po flasim për marrjen e masave administrative gjatë këtij procesi, por për pezullimin e licencës së përmbaruesve gjyqësorë privatë.

Ulsi Manja – Fjalën e ka kërkuar zoti Uitdehaag, i cili kërkon të japë një koment në lidhje me këtë që po diskutojmë.

Jos Uitdehaag – Në këtë kuadër nuk do të doja të bëja një krahasim me sistemin gjerman, sepse, në fakt, është pak e vështirë që të bëhet një krahasim i tillë përderisa shërbimi atje nuk është privat dhe nuk mundësohet alternativa e vetëpunësimit. Pra, në këtë kuadër nuk mund të bëjmë dot një krahasim me sistemin gjerman. Në qoftë se do ta mbeteshim në kuadrin e krahasimeve, unë do të doja të krahasoja situatën me vendet fqinje, si: Kosova, Maqedonia e Veriut, të cilat nuk është se kanë shumë ndryshime me sistemin shqiptar. Po të kalojmë tek aspekti i monitorimit dhe i kontrollit vendet si Kosova, Maqedonia e Veriut, Serbia kanë shumë ngjashmëri me propozimet që janë bërë për ndryshime. Në qoftë se do të kalojmë te krahasimi që u bë me sistemin holandez, nuk do ta bëja këtë gjë, sepse sistemi për përmbaruesit në Holandë është krejt ndryshe nga sistemi që synohet të aplikohet në Shqipëri.

Nëse do të mbetemi te sistemi i monitorimit dhe i kontrollit, për shembull, unë do të isha i detyruar të bëja raportime jo vetëm brenda sistemit të brendshëm, por edhe në organin e jashtëm kontrollues. Për shembull, mua do të më duhej t'i paraqisja gjithçka këtij organi të jashtëm kontrollues, si: llogarinë time bankare, një kopje të hipotekës, siguracionin e makinës, pra gjithçka.

Gjithashtu, nëse do t'u referohemi ndryshimeve që paraqiten te neni 2, këto janë veprimtari që tashmë aplikohen prej vitesh në Holandë, do të ishte shumë e vështirë të bënim një krahasim në këtë aspekt me një vend që ka vite që i aplikon këto parashikime. Këtu bëhet fjalë për mbledhjen e borxheve, dhënien e dokumentacioneve, bërjen e njoftimeve e kështu me radhë. Pra, nëse Shqipëria është në fillimet e veta, Holanda ka shumë vite që e aplikon këtë gjë. Në këtë kuadër, më së shumti do të mbeteshim me vendet fqinje që janë më të ngjashme në sistemin dhe praktikën e tyre me Shqipërinë, sesa me rastin e Holandës.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Uitdehaag!

Fjalën e ka zoti Fino.

Bashkim Fino – Së pari dua t’ju falënderoj ju për qetësinë që tregoni dhe për kohën e zgjatur, por edhe përfaqësuesit e Dhomës së Përmbauesve, Ministrinë e Financave dhe ekspertët e huaj.

Në fakt, unë dua t’ju falënderoj ju dhe Alket Hysenin, sepse para disa ditësh bëtë një tryezë shumë të rëndësishme dhe të gjerë me të gjithë aktorët e interesit, kam parasysh të gjithë përmbauesit privatë.

Sot, dëgjova me vëmendje të gjithë ekspozenë jo vetëm të relatorit dhe kolegëve të mi të opozitës, por edhe të ekspertëve të huaj dhe Ministrisë së Drejtësisë, por do të fokusohem te qëndrimet e zotit Malaveci, si kryetari i Dhomës së Përmbauesve Privatë.

Ju thatë se përmirësimi i ligjit ka efekte pozitive, siç ishin nenet 46 dhe 47 e të tjera, dhe unë jam dakord, por do të ndalem tek ato pika që nuk e përmirësojnë ligjin, të cilat i kam mbajtur shënim. Konstatimet që ju bëni mua më duket se rregullohen fare mirë gjatë diskutimit nen për nen.

Çfarë tha zoti Malaveci konkretisht? Ai tha: “Projektligjit i mungon dispozita tranzitore”. Mund të ketë të drejtë dhe kjo mund rregullohet shumë lehtë nga komisioni profesional, sepse mund të vendosim 2-3 nene si nene tranzitore dhe të zgjidhet si problem.

Zoti Malaveci tha: “Projektligji duhet të jetë i thjeshtë dhe jo kaq i ngarkuar”. Ju mund të keni të drejtë, sepse e lidhni punën tuaj me ligjin aktual, por ne që kemi eksperiencë pune shumë të gjatë e dimë që ndonjëherë në ligji vendosen shumë gjëra dhe shumë rregulla në brendësinë e tij, pra mund të futen jo vetëm pjesë të orientimit politik, por ndonjëherë edhe udhëzime dhe vendime qeverie e të tjera, pra ligji bëhet më i detajuar. Kur të fillojmë shqyrtimin nen për nen mund të heqim nene dhe gjëra që e ngarkojnë ligjin. Pra nuk është një vërejtje esenciale, në sensin që projektligji ka probleme.

Tjetër, ju thatë: “Ky është një ligj organik dhe jo procedural”. Po, është e vërtetë ky është një ligj organik dhe ne rreth kësaj do të diskutojmë dhe do ta miratojmë.

Dy shqetësimet që mua më bëjnë përshtypje nga zoti Malaveci ishin: “Bordi disiplinor është një kapitull represiv, në sensin e Dhomës së Përmbauesit Privat”. Pra, duke qenë një kapitull kaq i gjerë, duket sikur do të bëhet nami me bordin disiplinor dhe krijohet idea se ky bord krijohet për të goditur Dhomën e Përmbauesve Privatë. Mua nuk më duket kështu, sepse kjo u vlerësua edhe nga Ministria e Drejtësisë, edhe nga ekspertët ndërkombëtarë.

Sugjerimi tjetër që bëri zoti Malaveci mua më duket shumë interesant dhe i drejtë. Për këtë po ju drejtohem ju si kryetar i Komisionit të Ligjeve në kuadrin e të gjithë projektligjeve dhe paketës së reformës në drejtësi që në total bëjnë 27, le të bëjnë edhe një dhe të bëhen 28, pra është fjala për ligjin e përmbauesve shtetëror. Ky ligj, siç tha zoti Malaveci, të cilin e

mbështes plotësisht, është bërë që në vitin 2001 dhe sot jemi në 2019, pra kanë kaluar 18 vjet. Pse jo, Ministria e Drejtësisë apo ne, pra një grup deputetësh, të marrim iniciativën për ta rishikuar ligjin “Për përmbaruesit shtetërorë”, kjo në funksion paralel me këtë projektligj, të cilin po e diskutojmë jo vetëm në parim, por edhe nen për nen, të përmbaruesve privatë.

Pra, këto 4-5 të kontestime të bëra nga kryetari i Dhomës së Përmbarimit Privat, nëse isha i saktë në mbajtjen e shënimeve, unë mendoj se janë gjëra që mund të rregullohen gjatë diskutimit nen për nen. Në tërësi më intereson që ky ligj të bëhet për ta dhe për publikun dhe të jetë sa më i adoptueshëm dhe i ekzekutueshëm.

Zoti kryetar, ju falënderoj për të gjithë punën që është bërë, pse jo, këtë gjë duhet ta kishte thënë edhe zoti Malaveci, sepse është bërë një punë e jashtëzakonshme me mbledhjen e të gjithë aktorëve të interesit. Pra, ishte një punë që duhet ta kishte bërë zoti Malaveci me anëtarët e Dhomës dhe të vinte këtu me një draft apo me një mendim përfundimtar. Këtë punë e bëtë ju me zotin Alket Hyseni, ku thirrët të gjithë aktorët veç e veç për të marrë mendimet dhe sugjerimet e tyre, të cilat ndonjëherë e tejkaluan problematikën etike në këtë diskutim që është bërë. Prandaj unë mendoj që, në kuadrin e të gjitha këtyre që dëgjuam dhe kësaj ekspozije që unë bëra, sepse kam qenë aktor edhe atje, edhe këtu sot, ta kalojmë në parim projektligjin, duke mbajtur në konsideratë relatori dhe punonjësit tanë të Kuvendit të gjitha kontestimet që zoti Malaveci bëri këtu, me idenë dhe sensin për të korrigjuar ose për të rregulluar diçka me të vërtetë në interes të Dhomës së Përmbaruesve Privatë dhe të kalojmë më tej, sepse, me sa duket, do të kemi një diskutim, le të themi, më të detajuar kur të vijë puna... Se këtu u dëgjuan shumë gjëra: “përkufizimet nuk duhet të jenë kaq të tepërta, ky nen nuk duhet”... Domethënë, t’i lëmë më shumë kohë vetes për diskutimin nen për nen, rast pas rasti, dhe për të përafruar mendimet e të tria institucioneve që janë këtu: Ministria e Drejtësisë, Dhoma e Përmbaruesve Privatë dhe ekspertët ndërkombëtarë, për të arritur në konkluzione dhe për ta mbyllur këtë projektligj me dinjitet.

Shumë faleminderit, zoti kryetar!

Shumë faleminderit edhe juve!

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Fino!

Nuk e di nëse dikush tjetër nga kolegët ka diçka për të shtuar, por unë bashkohem me mendimin e kolegut Fino.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E doni fjalën për diskutim?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, mund të vazhdoni.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo replikë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Mund të vazhdoni me diskutimin dhe pastaj ecim më tutje.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pyetje, diskutim...

Keni pyetje? Ka ndonjë koleg tjetër pyetje për të bërë për projektligjin?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk ka pyetje. Vazhdojmë me diskutime nga kolegët.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pas zotit Fino, e kishte radhën zoti Xhafaj.

Fatmir Xhafaj – Bie dakord, si kolegët, se projektligji që po shqyrtojmë është pjesë e rëndësishme e grupit të projektligjeve të shërbimeve ligjore në kuadrin e paketës së reformës në drejtësi dhe funksioni i shërbimit përmbartimor është i rëndësishëm në sistemin e drejtësisë.

Jo rastësisht shërbimet ligjore, posaçërisht shërbimi përmbartimor ka qenë në fokus të analizës së thellë, që është bërë për sistemin aktual të drejtësisë në projektin, strategjinë, në planin e veprimit për shëndoshjen e vetë sistemit, sepse shërbimet ligjore në tërësi dhe shërbimi përmbartimor në veçanti luajnë një rol të rëndësishëm jo thjesht dhe vetëm, po se po, do të mendoja unë, në rritjen e besueshmërisë së qytetarëve të drejtësisë, por, mbi të gjitha, në cilësinë e dhënies së drejtësisë.

Ne kemi pasur dhe kemi problematika me dhënien e drejtësisë dhe ky është qëllimi kryesor i reformës për ta përmirësuar këtë gjë, por kemi pasur jo pak problematika, që lidhen me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore. Shpeshherë qytetarët i nënshtrohen një kalvari të gjatë për të marrë një vendim gjyqësor, por po kaq kohë ata shpeshherë harxhojnë edhe për ta ekzekutuar atë vendim gjyqësor. Ekzekutimi ka pasur dhe ka probleme në tërësinë e tij. Në këtë kontekst, ndryshimet përmirësuese, që janë synuar në kuadrin e paketës së reformës në drejtësi, kanë si qëllim përmirësimin e cilësisë së këtij shërbimi, ta bëjnë atë më të shpejtë dhe më efikas.

Unë besoj fort se koha e gjatë që ka marrë diskutimi për këtë projektligj, për tre vjet, tha kolegja, t'i ketë shërbyer, pikërisht, cilësisë së këtij projektligji dhe kjo gjë vlen për të gjithë aktorët që janë përfshirë në këtë proces, siç janë ekspertët, Dhoma dhe Ministria e Drejtësisë.

Në këtë kontekst, mendoj se çështjet e rëndësishme janë dy.

E para, raporti i këtij shërbimi me ligjin dhe qytetarët, se sa amendamentet që ne sjellim dhe që do të miratojmë do të mund ta bëjnë këtë shërbim jo thjesht më të shpejtë, por, më kryesorja dhe më e rëndësishmja, në standardet më të mira të shërbimit në këtë fushë.

E dyta, po ashtu jam i prirur të besoj, nisur edhe nga leximi që i kam bërë projektligjit, që amendamentet e propozuara do të synojnë ta mbrojnë rolin e përmbaruesit.

Këtu ka dy elemente.

Së pari, përmbaruesit duhet të mbrojnë vetveten me funksionin e tyre, në mënyrë që ai të jetë jo thjesht një funksion që u shërben atyre dhe interesave të tyre të ligjshme, por edhe qytetari, sepse për nga cilësia që ato ofrojnë në këtë shërbim te qytetari, tek ata do të rritet edhe niveli i besueshmërisë së tij dhe autoriteti i vetë figurës së përmbaruesve gjyqësorë do të ridimensionohet shumë më pozitivisht se deri tani. Nga ana tjetër, edhe shteti, duke e deleguar këtë kompetencë, duhet t'i japë mbrojtje shumë më të mirë përmbaruesit.

Përfshirja e ministrisë dhe instrumenteve të tjerë është tejet e dobishme, por ne duhet ta mbrojmë shërbimin përmbarimor nga disa ndërhyrje, të cilat kërkojnë që një pjesë të barrës së problematikave që kemi t'i faturohen përmbaruesit. Këtu, në këtë komision ne kemi qenë dëshmitarë të një debati të gjatë që ka qenë midis bankave dhe përmbaruesve. Personalisht, në atë kohë dhe tani, mbroj pikëpamjen që ka pasur dhe ka probleme, që lidhen me përmbaruesit, por ne nuk mund të lejojmë që lobimi i grupeve të caktuara të biznesit e posaçërisht atij bankar, të cenojë cilësinë e ekzekutimit dhe mbi të gjitha, duke synuar të ndryshojmë apo të rëndojmë rolin e përmbaruesit të ndikojmë apo të ndëshkojmë qytetarin. Në këtë rast është fjala, sidomos për çështjen e kredive të këqija. Në këtë kontekst, një raport sa më i drejtë mes funksionit të përmbaruesit dhe i operatorëve të tjerë të tregut, është një gjë pozitive. Unë besoj dhe dëshiroj shumë që ky projekt, me ndryshimet që sjell, të mundësojë bërjen efektive të kësaj.

Po ashtu, vlerësoj disa amendamente të rëndësishme që kanë të bëjnë me forcimin e kontrollit, të monitorimit, të disiplinës, të etikës.

Po ashtu, besoj se është e rëndësishme mbështetja që i duhet dhënë funksionit të përmbaruesit jashtë interesave lobiste që zhvillohen në këtë kuadër.

Bie dakord me kolegun, lidhur me rolin që ka pasur relatori në këtë proces. Unë jam në dijeni të faktit që ai ka bërë disa seanca dëgjimore me grupet e interesit dhe është përpjekur që të gjithë aktorët dhe faktorët që janë përfshirë në këtë projektligj me shumë kundërsense, të mund t'i harmonizojë për të dalë në një produkt sa më cilësor. Shpresoj se projekti i paraqitur t'ia ketë arritur dhe besoj se edhe debati do ta ndihmojë këtë.

Personalisht, duke e mbështetur projektin në tërësi dhe duke e votuar projektligjin në parim, unë nuk do të marr pjesë në diskutimin nen për nen, sepse si te projektligji “Për noterinë”, edhe te ky projektligj, meqë familjarët e mi janë në këtë lloj shërbimi, unë jam në konflikt interesi dhe do ta shmang veten nga debati nen për nen.

Ulsi Manja – Faleminderit, zoti Xhafaj!

Ka kolegë të tjerë për të diskutuar? Nuk ka.

Atëherë, kalojmë në shprehjen në parim të institucioneve që kemi ftuar në komision, në lidhje me dakordësinë dhe më pas do të kalojmë në votimin në parim të projektligjit.

Zoti Hyseni, jeni dakord ta kalojmë në votim në parim?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Atëherë, një konsideratë të fundit shumë shkurt nga zoti Hyseni.

Alket Hyseni – Duke mirëkuptuar çdo sugjerim, çdo vërejtje, çdo diskutim që u bë, unë u shpreha se jemi të hapur dhe është akoma e mundshme që deri në diskutimin nen për nen, po mundëm ta përmirësojmë akoma këtë draft, jemi të hapur dhe do të mirëpresim çdo koment të drejtpërdrejtë.

Unë e thashë se ne jemi nisur nga një filozofi e përgjithshme. Legjislatori shqiptar e kishte veçuar këtë shërbim për t’i ofruar një mundësi qytetarëve shqiptarë që në ekzekutimin e së drejtës përveç shërbimit përmbartimor gjyqësor shtetëror, të mund të ketë edhe alternativën te shërbimi përmbartimor privat, por me ligjin që kishim, nuk mundësohej realizimi i këtij misioni në kuptimin kushtetues, as në kuptimin personal të ushtrimit të biznesit 100% përmbartuesit.

Nga ana tjetër, praktika ka treguar se raportet mes kreditorëve dhe debitorëve ishin delikate dhe kërkonin rregullim më të qartë.

Nga ana tjetër, institucionet shtetërore kishin hasur problematika të caktuara qoftë në mangësi dispozitash, qoftë në tejkalim dispozitash. Këto jemi përpjekur t’i hedhim pas konsultimeve shumë të mëdha dhe unë gjej rastin këtu të falënderoj propozuesit, ekspertët (zotin Uitdehaag, zotin Peçi, kolegun e tij të Euralius-it dhe Ministrinë e Drejtësisë). Pavarësisht nga përmbartuesit që kam takuar, falënderoj në mënyrë të veçantë Dhomen Kombëtare e Përmbartuesve Gjyqësorë Privatë dhe nuk mund të lë pa përmendur edhe këshilltaren tonë, zonjën Koka, e cila ka punuar me durim dhe me përkushtim. Ne nuk kemi pasur asnjë synim tjetër, vetëm të bëjmë një ligj shumë më të mirë dhe unë konstatova këtu, sidomos nga eksperti ndërkombëtar, i cili pranoi se tani kemi një draft shumë më të avancuar edhe se drafti që është punuar nën ombrellën dhe nën orientimet e Euralius-it. Po ashtu, edhe Dhoma ka kaluar nga një pozicion shumë refraktar, në një pozicion, ku jo vetëm e pranon

ligjin, por shpreh edhe avantazhin që ka, duke pasur rezerva, patjetër, dhe unë garantoj që një sërë rezervash që kishte për draftin përfundimtar, si edhe shqetësimet që ka vetë ministria do të gjejnë pasqyrim. Janë ekuilibra delikatë, nga njëra anë institucioni që e licencon kërkon kontroll të plotë, por nga ana tjetër ne duam që t'i lëmë një kontroll të kufizuar lidhur me parimet që kemi hasur që ta ndajmë hetimin nga vendimmarrja dhe jemi përpjekur t'i japim një version të ndërmjetëm, por pozitiv. Nuk është thjesht ndjesi shqiptare është orientim i akteve ndërkombëtare.

Faleminderit, zoti kryetar, dhe secilit nga kolegët për mendimet e vyera që dha këtu!

Ulsi Manja- Faleminderit, zoti Hyseni!

Unë do të doja të bëja një përmbledhje. Së pari, të falënderoj ata që realisht janë përfshirë në këtë proces të gjatë konsultimi trevjeçar për këtë projektligj që vërtetë është ndër projektligjet e fundit të paketës së dytë të reformës në drejtësi të përbërë nga 27 ligje, por jo për nga rëndësia, sepse përmbartimi privat ofron një shërbim të drejtpërdrejtë për qytetarin. Unë bie dakord me të gjitha sugjerimet e kolegëve në diskutimet e tyre, edhe të kolegut Xhafaj, që në finale raporti është me ligjin dhe me qytetarin. Ky është një profesion i lirë që vetë shteti ia ka deleguar privatit, por që në fokus ka shërbimin për qytetarin. Bie dakord me kryetarin e dhomës që është një ligj organik dhe i thjeshtë, sepse ky ligj do të rregullojë veprimtarinë e organizimit dhe funksionimit të vetë dhomës, por edhe të veprimtarisë përmbartimore në Republikën e Shqipërisë.

Në fakt, veprimtarinë përmbartimore e ka rregulluar Kodi i Procedurës Civile. Përmbartimi në konceptin tim është gjykatë ekzekutimi, sepse shkojnë në ekzekutim vendime gjyqësore të formës së prerë dhe titujt ekzekutiv. Pra, kuadri procedural i veprimtarisë përmbartimore është zbatimi mot a mot i Kodit të Procedurës Civile dhe deri diku edhe i Kodit të Procedurës Administrative, sa i përket veprimtarisë përmbartimore. Pjesa tjetër pastaj bie dakord me të gjithë sugjerimet që u bënë këtu, por edhe në grupin e punës që pse jo ligji ka vend për t'u bërë më fleksibël, jo i ndërlikuar, siç edhe e sugjeroi kolegu Zeneli, por të kemi një ligj që t'i shërbejë së pari, atyre që punojnë me këtë ligj, por të ofrohet në mënyrë të shpejtë dhe me cilësi ai produkt që presin qytetarët nga ky shërbim.

Gjej rastin, gjithashtu, të bashkohem edhe me sugjerimet e kolegut Fino, mbase ka ardhur koha që të shihet edhe ligji për përmbartimin shtetëror që ta përshtatim edhe atë me kohën. Shumë gjëra kanë ecur në Shqipëri, ndërkohë që ne vazhdojmë të kemi një ligj të vitit 2001.

Falënderoj ekspertët ndërkombëtar dhe vendas të Ministrisë së Drejtësisë që u përfshinë në diskutimin e këtij projektligji, ekspertët e misionit Euralius, në veçanti zotin Uajt

Hak, zotin Peçi, zotin Dobi, Dhomën Kombëtare të Përmbaruesve Gjyqësor Privat, zoti Malaveci, relatorët, nismëtarët, këshilltarët e komisionit dhe të gjithë aktorët dhe faktorët që kanë dhënë kontribut me sugjerimet dhe komentet e tyre për përmirësimin e këtij projektligji për të arritur deri te votimi në parim.

Hedhim në votim në parim projektligji. Kush është dakord? Kundër? 3 kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Zoti Zeneli shpjegim vote kundër.

Alban Zeneli- Të nderuar kolegë, nuk do të zgjatem, sepse, në fakt, për këtë projektligj u bë një diskutim i gjatë, por ne grupi demokrat jemi kundër. E thashë edhe më sipër se nuk pasqyrohen asnjë nga sugjerimet dhe interesat për të përmirësuar rolin dhe punën e përmbaruesit gjyqësor privat dhe ky projektligj sipas mendimit tonë nuk i lehtëson aspak mundin e qytetarëve nga hallet që kanë në të gjithë sistemin e drejtësisë.

Ulsi Manja– Faleminderit, zoti Zeneli!

Në fakt, qëndrimi i kolegëve të opozitës është në vazhden e të gjitha votimeve në parim që ka zhvilluar opozita e vjetër dhe e re, kanë qenë kundër në parim të projektligjeve të reformës në drejtësi. Gjithsesi ky është qëndrim politik.

Faleminderit!

MBYLLET MBLEDHJA